



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.103

3 gusht

2011

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.10 443 datë 14.7.2011	Për ratifikimin e “Marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) për financimin e programit “Huaja e politikës së zhvillimit të reformës në sektorin social”	4099
Ligj nr.10 444 datë 14.7.2011	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9902, datë 17.4.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”	4107
Ligj nr.10 445 datë 14.7.2011	Për disa ndryshime në ligjin nr.10 222, datë 4.2.2010 “Për miratimin e kontratës së lidhur ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë “Eurocopter” për furnizimin me 5 helikopterë të mesëm shumërolësh”	4113
Ligj nr.10 446 datë 14.7.2011	Për miratimin e kontratës së lidhur ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë dhe “Eurocopter” për furnizimin me 1 (një) helikopter EC 145 VIP.....	4117
Ligj nr.10 447 datë 14.7.2011	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.....	4134

LIGJ
Nr.10 443, datë 14.7.2011

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË HUAS NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (IBRD) PËR FINANCIMIN E PROGRAMIT “HUAJA E POLITIKËS SË ZHVILLIMIT TË REFORMËS NË SEKTORIN SOCIAL””

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

 Ratifikohet “Marrëveshja e huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) për financimin e programit “Huaja e politikës së zhvillimit të reformës në sektorin social””.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.7058, datë 27.7.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

MARRËVESHJE HUAJE

HUAJA E POLITIKËS SË ZHVILLIMIT TË REFORMËS SË SEKTORIT SOCIAL NDËRMJET SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Datë _____, 201__

Marrëveshje e datës _____, 201__ e lidhur ndërmjet Shqipërisë (Huamarrësi) dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka) për qëllimin e dhënies së financimit në mbështetje të programit (sipas përkufizimit në shtojcën e kësaj marrëveshjeje). Banka ka vendosur të japë këtë financim mbi bazën, ndër të tjera të: a) veprimeve që Huamarrësi ka ndërmarrë sipas programit dhe që përshkruhen në seksionin I të grafikut 1 të kësaj marrëveshjeje; dhe b) ruajtjes nga Huamarrësi të një kuadri të përshtatshëm të politikës makroekonomike. Huamarrësi dhe Banka bien dakord si më poshtë:

Neni 1

Kushte të përgjithshme, përkufizime

1.01 Kushtet e përgjithshme (sipas përkufizimit në shtojcën e kësaj marrëveshjeje) përbëjnë një pjesë përbërëse të kësaj marrëveshjeje.

1.02 Përveç kur konteksti e kërkon ndryshe, termat me germa kapitale të përdorura në këtë marrëveshje kanë kuptimet që u janë veshur atyre në kushtet e përgjithshme ose në shtojcën e kësaj marrëveshjeje.

Neni 2 Huaja

2.01 Banka bie dakord t'i japë hua Huamarrësit, sipas termave dhe kushteve të përcaktuara ose referuara në këtë marrëveshje, shumën e tetëmbëdhjetë milionë e njëqind mijë euro (18 100 000 euro), ku kjo shumë mund të konvertohet herë pas here nëpërmjet një konvertimi të monedhës në pajtim me dispozitat e seksionit 2.7 të kësaj marrëveshjeje (huaja).

2.02 Huamarrësi mund të tërheqë shumat e huas në mbështetje të programit në pajtim me seksionin II të grafikut 1 të kësaj marrëveshjeje.

2.03 Tarifa fillestare e pagueshme nga Huamarrësi është e barabartë me një të katërtën e një për qind (0.25%).

2.04 Interesi i pagueshëm nga Huamarrësi për çdo periudhë interesi është në normën e barabartë me normën e referencës për monedhën e huas plus një marzh fiks, me kusht që me konvertimin e të gjithë ose një pjesë të shumës principale të huas, interesi i pagueshëm nga Huamarrësi gjatë periudhës së konvertimit për këtë shumë, përcaktohet në pajtim me dispozitat përkatëse të nenit 4 të kushteve të përgjithshme. Pavarësisht sa më sipër, nëse një shumë e balancës së tërhequr të huas mbetet e papaguar kur ajo bëhet e pagueshme dhe kjo mospagesë vazhdon për një periudhë prej tridhjetë ditësh, atëherë interesi i pagueshëm nga Huamarrësi në vend të kësaj llogaritët sipas parashikimit në seksionin 3.02 (e) të kushteve të përgjithshme.

2.05 Datat e pagesës janë 15 prill dhe 15 tetor të çdo viti.

2.06 Shuma principale e huas shlyhet në pajtim me grafikun e amortizimit të parashikuar në grafikun 2 të kësaj marrëveshjeje.

2.07 a) Huamarrësi mund të kërkojë në çdo kohë një prej konvertimeve të mëposhtme të termave të huas, me qëllim mundësimin e një menaxhimi të kujdesshëm të borxhit: i) një ndryshim të monedhës së huas, për të gjithë ose një pjesë të shumës principale të huas, të tërhequr ose të patërhequr në një monedhë të miratuar; dhe ii) një ndryshim të bazës së normës së interesit të zbatueshëm për të gjithë ose një pjesë të shumës principale të huas së tërhequr dhe të pashlyer nga një normë e variueshme të një normë fikse ose anasjellas, ose nga një normë e variueshme bazuar në një marzh të ndryshueshëm në një normë të variueshme bazuar në një marzh fiks.

b) Çdo konvertim i kërkuar në pajtim me paragrafin (a) të këtij seksioni, që pranohet nga Banka, konsiderohet "Konvertim", sipas përkufizimit në kushtet e përgjithshme dhe realizohet në pajtim me dispozitat e nenit 4 të kushteve të përgjithshme dhe të udhëzimeve për konvertimin.

2.08 Pa kufizim ndaj dispozitave të seksionit 5.08 të kushteve të përgjithshme (të rinumërtuara të tilla në pajtim me paragrafin 3 të seksionit II të shtojcës së kësaj marrëveshjeje dhe në lidhje me bashkëpunimin dhe konsultimin), Huamarrësi i jep menjëherë Bankës çdo informacion në lidhje me dispozitat e këtij neni 2, që banka mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme herë pas here.

Neni 3 Programi

3.01 Huamarrësi deklaron angazhimin e tij për programin dhe zbatimin e tij. Për këtë qëllim dhe në bazë të seksionit 5.08 të kushteve të përgjithshme:

a) Huamarrësi dhe Banka herë pas here, me kërkesë të një pale, shkëmben mendime mbi kuadrin e politikës makroekonomike të Huamarrësit dhe progresin e arritur në zbatimin e këtij programi;

b) para çdo shkëmbimi të tillë mendimesh, Huamarrësi i paraqet Bankës për rishikim dhe koment një raport mbi progresin e arritur në zbatimin e programit me hollësi të tilla që mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme Banka; dhe

c) pa kufizim ndaj dispozitave të paragrafëve (a) dhe (b) të këtij seksioni, Huamarrësi informon menjëherë Bankën për çdo situatë që do të kishte efektin e pezullimit material të objektivave të programit dhe për çdo veprim të ndërmarrë sipas programit, duke përfshirë çdo veprim të specifikuar në seksionin I të grafikut 1 të kësaj marrëveshjeje.

Neni 4
Mjetet mbrojtëse të bankës

4.01 Rasti shtesë i pezullimit përbëhet nga sa më poshtë, kryesisht një situatë që e bën të pamundur që programi apo një pjesë e konsiderueshme e tij të zbatohet.

4.02 Rasti shtesë i përshpejtimit përbëhet nga sa më poshtë, kryesisht një rast i specifikuar në seksionin 4.01 të kësaj marrëveshjeje dhe që vazhdon për 60 ditë pas njoftimit që i është bërë nga Banka Huamarrësit.

Neni 5
Hyrja në fuqi, përfundimi

5.01 Kusht shtesë i hyrjes në fuqi është që Banka të bindet në lidhje me progresin e arritur nga Huamarrësi në zbatimin e programit dhe me përshtatshmërinë e kuadrit të politikës makroekonomike të Huamarrësit.

5.02 Afati i hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje është nëntëdhjetë (90) ditë pas datës së nënshkrimit të saj.

Neni 6
Përfaqësuesi, adresat

6.01 Përfaqësuesi i Huamarrësit është Ministri i Financave

6.02 Adresa e Huamarrësit është:

Ministria e Financave

Nr.1, bulevardi "Dëshmorët e Kombit"

Tiranë, Shqipëri

Faks: 355 42 28494

6.03 Adresa e Bankës është:

Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim

1818 H Street, N.W.

Washington, D.C. 20433

Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Cable address

INTBAFRAD

Washington D.C.

Teleks

284423(MCI) ose 1-202-477-6391

64145(MCI)

Faks

Rënë dakord më _____, _____ në ditën dhe vitin e shkruar më sipër.

SHQIPËRIA

Nga përfaqësuesi i autorizuar

BANKA NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Nga përfaqësuesi i autorizuar

GRAFIKU 1
VEPRIMET E PROGRAMIT, DISPONIBILITETI I SHUMAVE TË HUAS

SEKSIONI I. VEPRIMET SIPAS PROGRAMIT

Veprimet që duhet të ndërmerren sipas programit. Veprimet e ndërmarra nga Huamarrësi sipas programit përfshijnë sa më poshtë:

1. Huamarrësi ka nxjerrë ndryshimin e ligjit për ndihmën dhe shërbimet sociale që, ndër të tjera, ka rishikuar sistemin e alokimit të burimeve të programit të ndihmës sociale dhe ekonomike për bashkitë, duke shtuar kriterin e varfërisë dhe duke përkufizuar kriteret e përshtatshmërisë së ekonomisë shtëpiake

bazuar në një formulë të përcaktimit të unifikuar, me elemente të faktorëve ndryshueshëm të shoqëruar nga statusi ekonomik dhe i varfërisë.

2. Këshilli i Ministrave të Huamarrësit nxori vendimet nr.602, 603 dhe 604 më 23 korrik 2010, që, ndërmjet të tjerash, ndryshuan formulën e indeksimit për programin e paaftësisë, duke ndarë përllogaritjen e rritjeve të përfitimeve nga indeksi i pagave dhe në vend të saj, duke lidhur rritjet e përfitimeve me inflacionin.

3. Huamarrësi ka nxjerrë ndryshimin e ligjit për ndihmën dhe shërbimet sociale që, ndër të tjera, për ekonomitë shtëpiake që marrin ndihmë sociale sipas programit të ndihmës ekonomike, prezantoi një bonus për ndjekjen nga fëmijët e moshës shkollore të arsimit të detyrueshëm.

4. Huamarrësi ka nxjerrë ndryshimin e ligjit për ndihmën dhe shërbimet sociale që, ndër të tjera, ka autorizuar krijimin e një regjistri kombëtar të kompjuterizuar për aplikantët dhe përfituesit e programeve të ndihmës sociale.

5. Huamarrësi ka nxjerrë ligjin për sigurimin e detyruar për kujdesin shëndetësor që, ndër të tjera, autorizon HII-në për të shtrirë mbulimin e sigurimit shëndetësor te përfituesit nga programi i ndihmës ekonomike dhe ka vendosur një paketë përfitimesh, duke mundësuar në këtë mënyrë vlerësimin e shpenzimeve të shërbimeve shëndetësore.

6. Huamarrësi ka nxjerrë ligjin e sigurimit të detyrueshëm për kujdesin shëndetësor që, ndër të tjera, përmban një rregull sistematik për të transferuar burimet te HII, duke përdorur koston e shpenzimeve si një kriter për transferimin dhe ka mbajtur shpërndarjen e kontributit të pagesave në nivelin e tashëm.

7. Këshilli i Ministrave të Huamarrësit nxori vendimin nr.1661 të datës 29 dhjetor 2008, që, ndër të tjera, unifikoi blerjen e financuar publikisht të shërbimeve shëndetësore te një agjenci, duke transferuar financimin e spitaleve te HII. Po ashtu, HII ka nënshkruar kontratat e përmbushjes me tridhjetë e nëntë spitale.

SEKSIONI II. DISPONIBILITETI I SHUMAVE TË HUAS

A. Të përgjithshme. Huamarrësi mund të tërheqë shumat e huas në pajtim me dispozitat e këtij seksioni dhe ato udhëzime shtesë që Banka mund të përcaktojë nëpërmjet njoftimit drejtuar Huamarrësit.

B. Alokimi i shumave të huas. Huaja (përveç shumave të kërkuara për të paguar tarifën fillestare) alokohet në një transh të vetëm tërheqjeje, nga e cila Huamarrësi mund të bëjë tërheqje nga shumat e huas. Alokimi i shumave të huas për këtë qëllim është i përcaktuar në tabelën e mëposhtme:

Alokimet	Shumat e huas (shprehura në euro)
1. Transhi me një tërheqje të vetme	18 054 750
2. Tarifa fillestare	45 250
Shuma totale	18 100 000

C. Kushtet e lirit të tërheqjes të transhit

1. Nuk mund të bëhet tërheqja e transhit me një tërheqje të vetme, përveç kur Banka është e bindur: a) në lidhje me programin e zbatuar nga Huamarrësi; dhe b) në lidhje me përshtatshmërinë e kuadrit të politikës makroekonomike të Huamarrësit.

D. Depozitat e shumave të huas. Përveç kur Banka mund të bjerë dakord ndryshe:

1. Të gjitha tërheqjet nga llogaria e huas depozitohen nga Banka në një llogari të caktuar nga Huamarrësi dhe të pranueshme për Bankën; dhe

2. Huamarrësi siguron që për çdo depozitim të një shume të huas në këtë llogari, një shumë ekuivalente pasqyrohet në sistemin e menaxhimit të buxhetit të Huamarrësit, në një mënyrë të pranueshme për Bankën.

E. Shpenzimet e përjashtuara. Huamarrësi merr përsipër që shumat e huas të mos përdoren për të financuar shpenzimet e përjashtuara. Nëse Banka në çdo moment konstaton që një shumë e huas është përdorur për të bërë një pagesë për një shpenzim të përjashtuar, Huamarrësi, menjëherë pas njoftimit të Bankës, i rimbursos Bankës një shumë të barabartë me shumën e kësaj pagese. Shumat e rimbursuara sipas kërkesës së Bankës anulohen.

F. Data e mbylljes. Data e mbylljes është 30 prill 2012.

GRAFIKU 2
GRAFIKU I AMORTIZIMIT

1. Tabela e mëposhtme përcakton datat e pagesave të principalit të huas dhe përqindjen e shumës totale të principalit të huas të pagueshme për secilën datë të pagesës së principalit (pjesa e këstit). Nëse shumat e huas janë tërhequr plotësisht në datën e parë të pagesës së principalit, shuma e principalit të huas që është e shlyeshme nga Huamarrësi për secilën datë të pagesës së principalit përcaktohet nga Banka duke shumëzuar: a) balancën e tërhequr të huas në datën e parë të pagesës së principalit; me b) pjesën e këstit për çdo datë të pagesës së principalit, dhe kjo shumë e shlyeshme rregullohet sipas nevojës, për të zbritur çdo shumë që përmendet në paragrafin 4 të këtij grafiku, tek i cili zbatohet konvertimi i monedhës.

Data e pagesës së principalit	Pjesa e këstit (shprehur si përqindje)
Në çdo 15 prill dhe 15 tetor Duke filluar më 15 tetor 2016 Deri më 15 prill 2026	5%

2. Nëse shumat e huas nuk janë tërhequr plotësisht në datën e parë të pagesës së principalit, shuma e principalit të huas së shlyeshme nga Huamarrësi në çdo datë të shlyerjes së principalit, përcaktohet si më poshtë:

a) Në masën që çdo shumë e huas është tërhequr në datën e parë të pagesës së principalit, Huamarrësi shlyen balancën e tërhequr të huas në këtë datë në pajtim me paragrafin 1 të këtij grafiku.

b) Çdo shumë e tërhequr pas datës së parë të pagesës së principalit shlyhet në çdo datë të pagesës së principalit që bie pas datës së kësaj tërheqjeje në shumat e përcaktuara nga Banka, duke shumëzuar shumën e çdo tërheqjeje të tillë me një thyesë, numëruesi i së cilës është pjesa e këstit origjinal, i specifikuar në tabelën e paragrafit 1 të këtij grafiku për datën përkatëse të pagesës së principalit (pjesa e këstit origjinal) dhe emëruesi i së cilës është shuma e të gjitha pjesëve të mbetura të këstit origjinal për datat e pagesës së principalit që bien në ose pas kësaj date, ku këto shuma të shlyeshme duhet të përshtaten, përkatësisht, për të zbritur çdo shumë të përmendur në paragrafin 4 të këtij grafiku, për të cilën zbatohet një konvertim monedhe.

3.a) Shumat e huas të tërhequra brenda dy muajve kalendarikë para çdo date të pagesës së principalit, thjesht për qëllim të përlllogaritjes së shumave të principalit të pagueshme në çdo datë të pagesës së principalit, trajtohet si e tërhequr dhe e mbetur në datën e dytë të pagesës së principalit pas datës së tërheqjes dhe është e shlyeshme në çdo datë të pagesës së principalit që fillon me datën e dytë të pagesës së principalit pas datës së tërheqjes.

b) Pavarësisht dispozitave të nënparagrafit (a) të këtij paragrafi, nëse në një moment të caktuar Banka miraton një sistem faturimi sipas datës së kërkueshme, sipas të cilit faturat lëshohen në ose pas datës përkatëse të pagesës së principalit, dispozitat e këtij nënparagrafi nuk vazhdojnë të zbatohen për tërheqjet e bëra pas miratimit të këtij sistemi faturimi.

4. Pavarësisht dispozitave të paragrafëve 1 dhe 2 të këtij grafiku, pas konvertimit të monedhës të të gjithë ose një pjese të balancës së tërhequr të huas në një monedhë të aprovuar, shuma e konvertuar në këtë mënyrë në monedhën e aprovuar, që është e shlyeshme në çdo datë të pagesës së principalit që vjen pas periudhës së konvertimit, përcaktohet nga Banka duke shumëzuar këtë shumë në monedhën e saj të përcaktimit menjëherë para konvertimit me: i) normën e këmbimit që reflekton shumat e principalit në monedhën e aprovuar të pagueshme nga Banka sipas transaksionit të garancisë së monedhës në lidhje me konvertimin; ose ii) nëse banka vendos në këtë mënyrë në pajtim me udhëzimet e konvertimit, komponentin e normës së këmbimit të normës së kontrollit.

5. Nëse balanca e tërhequr e huas shprehet në më shumë se një monedhë huaje, dispozitat e këtij grafiku zbatohen veçmas për shumën e shprehur në secilën monedhë të huas, për të dhënë një grafik të veçantë amortizimi për secilën shumë të tillë.

SHTOJCË

SEKSIONI I. PËRKUFIZIME

1. “Shpenzim i përjashtuar” është çdo shpenzim:

a) Për mallra dhe shërbime të ofruara sipas një kontrate që ka financuar ose ka rënë dakord të financojë një institucion ose agjenci financiare kombëtare ose ndërkombëtare e ndryshme nga Banka ose shoqata, ose që Banka ose shoqata ka financuar ose ka rënë dakord të financojë sipas një huaje, kredie ose granti tjetër.

b) Për mallrat e përfshira në grupet ose nëngrupet e mëposhtme të Klasifikimit Standard të Tregtisë Ndërkombëtare, botimi 3 (SITC, Rev.3), publikuar nga Kombet e Bashkuara në Dokumentet Statistike, seria M, nr.34/Rev.3 (1986) (SITC), ose një grup apo nëngrup pasues sipas rishikimeve të SITC-së, siç përcaktohet nga Banka duke njoftuar Huamarrësin:

Grupi	Nëngrupi	Përshkrimi i artikullit
112		Pijet alkoolike
121		Duhan i papërpunuar, mbeturina duhani
122		Duhan i përpunuar (pavarësisht nëse përmbajnë zëvendësues duhani)
525		Materiale radioaktive ose të ngjashme
667		Perla, gurë të çmuar ose gjysmë të çmuar, të punuar ose të papunuar
718	718.7	Reaktorë nuklearë ose pjesë të tyre, elemente të karburantit (shufra), të parrezatuara për reaktorët nuklearë
728	728.43	Makineri për përpunimin e duhanit
897	897.3	Zbukurime ari, argjendi ose i metaleve të grupit të platiniumit (përveç orëve dhe kasave të orëve të dorës) dhe produkteve të arpunuesve ose argjendpunuesve (duke përfshirë kompletet e gurëve të çmuar)
971		Arin, jomonetar (duke përjashtuar xehorët dhe koncentratet e arit)

c) Për mallrat e destinuar për një qëllim ushtarak ose paraushtarak, ose për një konsum luksoz.

d) Për mallrat e rrezikshme për ambientin, prodhimi, përdorimi ose importi i të cilave ndalohej me ligjet e Huamarrësit ose marrëveshjet ndërkombëtare ku Huamarrësi është palë.

e) Në lidhje me çdo pagesë të ndaluar me vendim të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, të marrë sipas kapitullit VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara; dhe

f) Në lidhje me të cilën Banka konstaton që përfaqësues të Huamarrësit ose marrës të tjerë të shumave të huas janë përfshirë në praktika korruptive, mashtruese, të fshehta ose detyruese, ndërsa Huamarrësi (ose marrësi tjetër) nuk ka marrë veprime në kohë dhe të përshtatshme, të pranueshme për Bankën për të trajtuar këto praktika kur këto ndodhin.

2. “Kushte të përgjithshme” janë “Kushte të përgjithshme për huat e Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim”, të datës 31 korrik 2010, me modifikimet e parashikuara në seksionin II të kësaj shtojce.

3. Shkurtimi “HII” i referohet Institutit të Sigurimeve Shëndetësore të Huamarrësit, që është themeluar në vitin 1995 si një skemë sigurimesh që ofron një gamë të gjerë shërbimesh dhe kontrollon koston administrative, duke synuar sigurimin e barazisë.

4. Shkurtimi “NE” i referohet ndihmës ekonomike, që është një program ndihme sociale të përfitimit në para të themeluar me ligjin nr.9355, të datës 10.3.2005.

5. “Programi” është programi i veprimeve, objektivave dhe politikave të projektuara për të përmirësuar efektivitetin e rrjeteve të sigurisë sociale dhe për të forcuar efikasitetin dhe barazinë e shpenzimeve shëndetësore në një ambient të qëndrueshëm fiskal dhe të parashikuar ose të referuar në letrën e datës 18 mars 2011, nga Huamarrësi drejtuar Bankës që deklaroi angazhimin e Huamarrësit për zbatimin e programit dhe që kërkon asistencën nga Banka në mbështetje të programit gjatë ekzekutimit të tij.

6. “Transhi me një tërheqje të vetme” është shuma e huas e alokuar në kategorinë me titull “Transh me një tërheqje të vetme” në tabelën e përcaktuar në pjesën B të seksionit II të grafikut 1 të kësaj marrëveshjeje.

7. “Ndryshim i ligjit për ndihmën dhe shërbimet sociale” janë ndryshimet e ligjit nr.9355 “Ligj për ndihmën dhe shërbimet sociale”, të datës 3.10.2005, ndryshimet e të cilit janë aprovuar nga Këshilli i Ministrave më 19.1.2011.

8. “Ligj mbi sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor” është ligji nr.1, “Ligji mbi sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor”, të datës 6 janar 2011.

SEKSIONI II. MODIFIKIMET E KUSHTEVE TË PËRGJITHSHME

Modifikimet e kushteve të përgjithshme janë si më poshtë:

1. Fjalja e fundit e paragrafit (a) të seksionit 2.03 (në lidhje me aplikimet për tërheqje) fshihet në tërësinë e tij.

2. Seksionet 2.04 (llogaritë e përcaktuara) dhe 2.05 (shpenzimet e përshtatshme) fshihen në tërësinë e tyre dhe seksionet e tjera në nenin 2 rinumërohen përkatësisht.

3. Seksionet 5.01 (ekzekutimi i projektit në përgjithësi) dhe 5.09 (menaxhimi financiar, pasqyrat financiare, auditët) fshihen në tërësinë e tyre dhe seksionet e tjera në nenin 5 rinumërohen përkatësisht.

4. Paragrafi (a) i seksionit 5.05 (rinumërtuar si i tillë në pajtim me paragrafin 3 të mësipërm dhe në lidhje me përdorimin e mallrave, punëve dhe shërbimeve) fshihet në tërësinë e tij.

5. Paragrafi (c) i seksionit 5.06 (rinumërtuar si i tillë në pajtim me paragrafin 3 të mësipërm) modifikohet me tekstin e mëposhtëm:

Seksioni 5.06. Planet, dokumentet, regjistrat

... c) Huamarrësi mban të gjitha regjistrat (kontratat, porositë, faturat, fletë-pagesat dhe dokumente të tjera), që evidentojnë shpenzimet sipas huas deri në dy vjet pas datës së mbylljes. Huamarrësi u jep mundësi përfaqësuesve të bankës për të shqyrtuar regjistrat.

6. Paragrafi (c) i seksionit 5.07 (rinumërtuar si i tillë në pajtim me paragrafin 3 të mësipërm) modifikohet me tekstin e mëposhtëm:

Seksioni 5.07. Monitorimi dhe vlerësimi i programit

... c) Huamarrësi përgatit ose mundëson përgatitjen dhe i paraqet Bankës jo më vonë se gjashtë muaj pas datës së mbylljes një raport me atë objekt dhe hollësi që Banka e kërkon në mënyrë të arsyeshme mbi zbatimin e programit, përmbushjen e detyrimeve nga palët e huas dhe Banka, sipas marrëveshjeve ligjore dhe realizimin e qëllimeve të huas.

7. Termat dhe përkufizimet e mëposhtme të parashikuara në shtojcë modifikohen ose fshihen si më poshtë dhe termat dhe përkufizimet e mëposhtme të reja shtohen në rend alfabetik në shtojcë si më poshtë, ku termat rinumërohen përkatësisht:

a) Përkufizimi i termit “Shpenzim i përshtatshëm” modifikohet me tekstin e mëposhtëm:

“Shpenzime të përshtatshme” nënkupton çdo përdorim ku vendoset huaja në mbështetje të programit, të ndryshëm nga financimi i shpenzimeve që përjashtohen në pajtim me marrëveshjen e huas.

b) Termi “Pasqyra financiare” dhe përkufizimi i tij fshihen në tërësinë e tyre.

c) Termi “Projekt” modifikohet për t’u lexuar “Program” dhe përkufizimi i tij modifikohet me tekstin e mëposhtëm (dhe të gjitha referencat të “Projekti” në të gjitha kushtet e përgjithshme konsiderohen të jenë referenca të “Programi”):

“Program” është programi i referuar në marrëveshjen e huas, në mbështetje të së cilës jepet huaja.

LETËR SHITESË
SHQIPËRI

_____, 2011

Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim
1818 H Street, N.W.
Uashington, D.C. 20433
Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Lënda: Huaja nr. _____ AL
(Hua e Politikës së Zhvillimit të Reformës së sektorit Social)
Neni 6 i kushteve të përgjithshme
Të dhëna financiare dhe ekonomike

Të nderuar zotërinj dhe zonja:

Në lidhje me marrëveshjen e huas të kësaj date, ndërmjet Shqipërisë (vend anëtar) dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka), që jep një hua (huaja) për projektin e sipërshënuar dhe kushtet e përgjithshme (kushtet e përgjithshme), që janë të zbatueshme për marrëveshjen e huas, po u shkruaj në emër të vendit anëtar për të parashtruar sa më poshtë:

1. Ne jemi në dijeni dhe biem dakord që, për qëllimet e seksionit 6.01 të kushteve të përgjithshme, vendit anëtar i kërkohet nga Banka të raportojë “borxhin e jashtëm afatgjatë” (sipas përcaktimit në Manualin e Sistemit të Raportimit të debitorit të Bankës Botërore, të datës janar 2000 (DRSM)), në pajtim me DSRM-në dhe veçanërisht të njoftojë Bankën për “Marrjen e huave të reja” (sipas përcaktimit në DRSM), jo më vonë se 30 ditë pas përfundimit të tremujorit, gjatë të cilit realizohet borxhi, dhe t’i njoftojë Bankës “transaksionet sipas huave” (sipas përcaktimit në DRSM) një herë në vit, jo më vonë se 31 mars të vitit pas vitit që mbulohet nga raporti.

2. Ne citojmë që nuk ekziston asnjë barrë (sipas përkufizimit në kushtet e përgjithshme), përveç atyre të përjashtuara në pajtim me paragrafin (c) të seksionit 6.02 të kushteve të përgjithshme, në asnjë send pasuror publik (sipas përcaktimit në kushtet e përgjithshme), si garanci për ndonjë borxh të jashtëm (sipas përcaktimit në kushtet e përgjithshme). Nuk ka asnjë vonesë në lidhje me ndonjë borxh publik të jashtëm (sipas përcaktimit në DSRM). Jemi në dijeni që Banka në dhënien e huas mund të mbështetet në pasqyrimet e parashtruara ose të përmendura në këtë letër.

3. Jemi të lutur të konfirmoni pëlqimin e tij për sa më sipër, duke bërë nënshkrimin nga një përfaqësues i autorizuar i Bankës në vendin e caktuar më poshtë.

Sinqerisht i juaji
Shqipëri

Nga _____
Përfaqësues i autorizuar

Rënë dakord:
Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim

Nga _____
Përfaqësues i autorizuar

LIGJ
Nr.10 444, datë 14.7.2011

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.9902, DATË 17.4.2008 “PËR MBROJTJEN E KONSUMATORËVE”¹

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.9902, datë 17.4.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Neni 2 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 2
Fusha e zbatimit

“Ky ligj përfshin të gjitha llojet e marrëdhënieve ndërmjet tregtarëve dhe konsumatorëve, që kanë të bëjnë me mallrat e konsumatorëve apo shërbime. Dispozitat e këtij ligji nuk do të zbatohen, kur në dispozitat e tjera ligjore për fushat përkatëse jepen trajtime më të favorshme për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve.”.

Neni 2

Në nenin 3 bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Fjalja e fundit e pikës 6 shfuqizohet.
2. Në pikën 15, pas fjalës “malli” shtohen fjalët “apo shërbimi”.
3. Pas pikës 15 shtohet pika 15.1 me këtë përmbajtje:

“15.1. “Ftesë për blerje” është një komunikim tregtar, që tregon në një mënyrë të përshtatshme, nëpërmjet mjeteve të përdorura të komunikimit tregtar, karakteristikat e produktit apo të shërbimit dhe çmimit, duke i mundësuar në këtë mënyrë konsumatorit kryerjen e blerjes;”.

4. Pas pikës 18 shtohet pika 19 me këtë përmbajtje:

“19. “Mjet i qëndrueshëm” është çdo mjet, i cili i mundëson konsumatorit ruajtjen e informacionit të drejtuar personalisht atij, në mënyrë që të lejojë referimin për qëllime informimi, në të ardhmen, për një periudhë kohe të përshtatshme, dhe që lejon riprodhimin e pandryshuar të informacionit të ruajtur.”.

Neni 3

Në nenin 17 shkronja “B” bëhen këto ndryshime:

1. Pika 2 shfuqizohet.
2. Pika 7 ndryshohet si më poshtë:

¹ Ky ligj është përafshuar plotësisht me:

Direktivën 2008/48/KE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 23 prill 2008 “Mbi marrëveshjet e kreditit për konsumatorët, e cila shfuqizon Direktivën e Këshillit 87/102/EEC”. Numri CELEX: 32008L0048, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, nr.133, datë 22.5.2008, faqe 66 - 92.

Direktivën 2008/122/KE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 14 janar 2009 “Mbi mbrojtjen e konsumatorit, në lidhje me disa aspekte të kontratave me më shumë se një pronë, të produkteve të pushimeve afatgjata, rishitjes dhe shkëmbimit”. Numri CELEX: 32008L0122, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, nr.33, datë 3.2.2009, faqe 10-30.

“7. Kërkesa e pagesës së menjëhershme ose të shtyrë nga tregtari për mallrat apo shërbime, në lidhje me furnizimin ose kthimin apo ruajtjen e këtyre mallrave a shërbimeve të pakërkua nga konsumatori.”.

Neni 4

Nenet 19, 20, 21 dhe 23 shfuqizohen.

Neni 5

Në nenin 27 bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Pas pikës 3 shtohet pika 3.1 me këtë përmbajtje:

“3.1. Vlerësimi i natyrës së padrejtë të kushteve nuk lidhet as me objektin kryesor të kontratës, as me përshtatshmërinë e çmimeve ose pagesave të mallrave apo shërbimeve të furnizuara, për sa kohë këto kushte janë hartuar në një gjuhë të qartë e të kuptueshme.”.

2. Në pikën 4, pas shkronjës “l” shtohet shkronja “m” me këtë përmbajtje:

“m) ndryshojnë kushtet e kontratave të kredisë, veçanërisht metodën/metodologjinë e përlllogaritjes së normës së interesit dhe elementet e saj, pa marrë më parë pëlqimin e konsumatorit.”.

Neni 6

Në nenin 28, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Në rastin e kontratave, ku të gjitha ose disa kushte që u ofrohen konsumatorëve janë të shkruara, atëherë këto duhet të kenë një formulim të kuptueshëm në gjuhën shqipe dhe një paraqitje të qartë e të dallueshme. Shkrimi i përdorur të jetë “Times New Roman”, me madhësi të karakterit të shkrimit, të paktën 10. Në rast se ka dyshime rreth kuptimit të kushtit të kontratës, atëherë interpretimi është në favor të konsumatorëve.”.

Neni 7

Pas nenit 33 shtohet neni 33/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 33/1

Përputhja kontraktuale e shërbimeve

Tregtari i ofron konsumatorit shërbime, në përputhje me kushtet e kontratës. Tregtari është përgjegjës për mospërputhjet e shërbimit të siguruar konsumatorit me kushtet e kësaj kontrate.”.

Neni 8

Në nenin 34 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 1, fjalët “me një vlerë jo më pak se 7 000 lekë” zëvendësohen me fjalët “me një vlerë jo më pak se 10 000 lekë”.

2. Në fund të pikës 2 shtohen shkronjat “c”, “ç” dhe “d” me këtë përmbajtje:

“c) kontratat për furnizimin e mallrave ose të shërbimeve, me kusht që të plotësojnë të tria kushtet e mëposhtme:

i) kontrata është lidhur në bazë të katalogut të tregtarit, për të cilin konsumatori ka mundësinë e leximit në mungesë të përfaqësuesit të tregtarit;

ii) ekziston qëllimi i vazhdimit të kontakteve midis përfaqësuesit të tregtarit dhe konsumatorit, në lidhje me këtë ose çdo transaksion të mëpashtëm;

iii) katalogu, së bashku me kontratën, informojnë qartë konsumatorin për të drejtën e tij të rikthimit të mallrave te tregtari, brenda një periudhe jo më pak se 14 ditë kalendarike nga data e marrjes së mallit ose, në të kundërt, anulimin e kontratës, pa asnjë penalizim, me përjashtim të kujdesit të arsyeshëm për mallin.

ç) kontratat e sigurimit;

d) kontratat për titujt.”.

Neni 9

Në nenin 36 pika 3, shkronjat “d” dhe “dh” shfuqizohen.

Neni 10

Në nenin 37 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 2 bëhen këto ndryshime:

a) paragrafi i parë ndryshohet si më poshtë:

“Konsumatori duhet të marrë nga tregtari konfirmimin me shkrim ose me ndonjë mjet tjetër, të qëndrueshëm, në një kohë të arsyeshme gjatë zbatimit së kontratës dhe jo më vonë se çasti i dorëzimit të mallit, kur malli nuk iu dorëzohet palëve të treta të lidhura me to, përveç informacionit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, edhe për informacionet e mëposhtme:”.

b) Në shkronjën “ç”, fjala “vendimi” zëvendësohet me fjalën “kushtet”.

2. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Konsumatori ka të drejtë të heqë dorë nga kontrata pa penalizim dhe pa dhënë asnjë arsye, brenda një afati prej 14 ditësh kalendarike:

a) Në rastin e mallit, ky afat fillon nga data e marrjes së mallit nga konsumatori, kur tregtari ka plotësuar detyrimet e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni. Për shkak të ushtrimit të heqjes dorë, konsumatorit i ngarkohet vetëm kostoja e kthimit të mallit.

b) Në rastin e shërbimit, ky afat fillon nga data e lidhjes së kontratës ose nga data kur tregtari plotëson detyrimet e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, në rast se kjo datë është më pas datës së lidhjes së kontratës.

c) Në rastin e kontratave për pensionin vullnetar ose për sigurimin e jetës, në shërbimin në largësi, afati i heqjes dorë shtrihet deri në 30 ditë kalendarike.”.

3. Pas pikës 6 shtohet pika 7 me këtë përmbajtje:

“7. Detyrimet e përcaktuara në pikat 1 deri në 5 të këtij neni nuk zbatohen për:

a) kontratat për furnizimin me mallra ushqimore, pije ose mallra të tjera të paracaktuara për konsum të shpejtë, të furnizuara në banesën e konsumatorit apo në vendin e tij të punës nga shërbime të rregullta shpërndarjeje;

b) kontratat për kushtet e fjetjes, të transportit, të furnizimit me ushqim (catering) ose shërbime të kohës së lirë, kur tregtari angazhohet dhe kur kontrata është lidhur për t'i siguruar këto shërbime në një datë të caktuar ose brenda një periudhe të caktuar.”.

Neni 11

Titulli i kreut II në pjesën VII ndryshohet si më poshtë:

“KREU II KONTRATAT E PËRDORIMIT ME AFAT TË PRODUKTIT TË PUSHIMIT AFATGJATË, TË RISHITJES DHE TË SHKËMBIMIT”

Neni 12

Neni 42 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 42

Kuptimi i kontratave të përdorimit me afat të produktit të pushimit afatgjatë, të rishitjes dhe të shkëmbimit

1. Kontratë e përdorimit me afat është një kontratë me afat më shumë se një vit, sipas së cilës konsumatori, sipas rastit, siguron të drejtën e përdorimit të akomodimit për një ose më shumë net, për më shumë se një periudhë.

2. Kontratë e produktit të pushimit afatgjatë është një kontratë me afat më shumë se një vit, sipas së cilës konsumatori, sipas rastit, siguron kryesisht të drejtën e përfitimit të uljeve të çmimit ose përfitime të tjera, në lidhje me akomodimin, veçmas ose së bashku me shërbimin e udhëtimit apo ndonjë shërbim tjetër.

3. Kontratë rishitjeje është një kontratë, sipas së cilës tregtari, sipas rastit, ndihmon konsumatorin të shesë ose të blejë një produkt të përdorimit me afat ose të një produkti të pushimit afatgjatë.

4. Kontratë e shkëmbimit është një kontratë, sipas së cilës konsumatori, sipas rastit, bashkohet në një sistem shkëmbimi, i cili i lejon konsumatorit mundësinë e përdorimit të akomodimit ose shërbime të tjera, në shkëmbim të dhënies përkohësisht të persona të tjerë të mundësisë së përdorimit të përfitimeve të të drejtave, që rrjedhin nga kontrata e konsumatorit e përdorimit me afat.”.

Neni 13

Neni 43 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 43

Detyrime të përgjithshme dhe të veçanta

1. Në një kohë të arsyeshme, përpara se konsumatori të pranojë ndonjë ofertë ose të lidhë një kontratë të përdorimit me afat të produktit të pushimit afatgjatë, të rishitjes apo të shkëmbimit, tregtari i siguron atij, në mënyrë të qartë e të kuptueshme, të gjithë informacionin e nevojshëm.

2. Tregtari i siguron konsumatorit kontratën e përdorimit me afat të produktit të pushimit afatgjatë, të rishitjes apo të shkëmbimit, me shkrim ose me një mjet tjetër të qëndrueshëm, në gjuhën shqipe.

3. Kur objekti i kontratës së përdorimit me afat të produktit të pushimit afatgjatë, të rishitjes apo të shkëmbimit, është i vendosur në një vend të huaj, tregtari i siguron konsumatorit një përkthim të noterizuar dhe të certifikuar të kontratës në gjuhën shqipe.

4. Konsumatori ka të drejtën e heqjes dorë nga kontratat e përdorimit me afat të produktit të pushimit afatgjatë, të rishitjes apo të shkëmbimit, pa penalizim dhe pa dhënë arsye, brenda një afati prej 14 ditësh kalendarike, duke filluar nga data e lidhjes së kontratës ose nga data kur palët nënshkruajnë një kontratë paraprake detyruese apo nga data kur konsumatori merr kontratën a çdo kontratë paraprake detyruese, në qoftë se kjo ditë është më vonë se data e lidhjes së kontratës apo kontratës paraprake.

5. Kur çmimi i kontratës së përdorimit me afat të produktit të pushimit afatgjatë, të rishitjes apo të shkëmbimit, mbulohet plotësisht ose pjesërisht nga kredia e dhënë konsumatorit nga tregtari ose nga një palë e tretë, në bazë të një marrëveshjeje ndërmjet palës së tretë dhe tregtarit, marrëveshja e kredisë përfundon pa penalizim për konsumatorin, nëse konsumatori ushtron të drejtën e heqjes dorë nga kontratat e përdorimit me afat, të produktit të pushimit afatgjatë, të rishitjes apo të shkëmbimit.”.

Neni 14

Në nenin 44, pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Përfshihen nga fusha e veprimit të këtij kreu marrëveshjet e kredisë:

a) që janë të siguruara me anë të hipotekës ose nga ndonjë sigurim tjetër i krahasueshëm, që përdoret zakonisht mbi pronën e paluajtshme, apo të siguruara nëpërmjet një të drejte që lidhet me pronën e paluajtshme;

b) qëllimi i të cilave është fitimi/marrja ose ruajtja e të drejtave të pronësisë mbi tokën ose mbi ndërtesa ekzistuese apo të projektuara;

c) që përfshijnë një shumë totale të kredisë më pak se 30 mijë lekë ose më shumë se 10 milionë lekë;

ç) marrëveshjet e qirasë ose lizingut ku detyrimi për blerjen e objektit të marrëveshjes nuk është përcaktuar në vetë marrëveshjen ose në ndonjë marrëveshje të veçantë. Një detyrim i tillë do të prezumohet se ekziston, nëse është vendosur kështu në mënyrë të njëanshme nga kreditori;

d) në formën e një overdrafti dhe ku kredia duhet të shlyhet brenda një muaji;

dh) ku kredia është dhënë pa interes dhe pa ndonjë detyrim/pagesë tjetër dhe marrëveshjet e kredisë, sipas kushteve të të cilave kredia duhet të shlyhet brenda tre muajve dhe janë për t'u paguar vetëm detyrime me vlerë të vogël, të papërfillshme;

e) ku kredia është dhënë nga punëdhënësi punonjësve të tij, si një veprimtari dytësore pa interes ose me një normë vjetore të përqindjes së pagesave/detyrimeve më të ulët se ato që ekzistojnë në treg dhe që përgjithësisht nuk janë të ofruara për publikun;

- e) që janë rezultat i një zgjidhjeje të arritur në gjykatë ose përpara një autoriteti tjetër ligjor;
- f) që kanë të bëjnë me një pagesë të shtyrë, pa detyrime/pagesa, të një borxhi ekzistues;
- g) prej lidhjes së të cilave konsumatorit i kërkohet që të depozitojë një send si siguri në ruajtje të kreditorit dhe ku përgjegjësia e konsumatorit ndaj këtij sendi të lënë peng është rreptësisht e kufizuar;
- gj) që kanë të bëjnë me huat e dhëna ndaj një publiku të kufizuar, në bazë të një dispozite ligjore, me qëllim të interesit të përgjithshëm dhe me norma interesi më të ulëta se ato që ekzistojnë në treg, ose pa interes, apo në kushte të tjera që janë më të favorshme për konsumatorin se ato që ekzistojnë në treg dhe me norma interesi jo më të larta se ato që ekzistojnë në treg.”.

Neni 15

Në nenin 45 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Çdo publicitet, në lidhje me marrëveshjet e kredisë, e cila tregon një normë interesi apo ndonjë shifër, në lidhje me çmimin e kredisë për konsumatorët, duhet të përfshijë informacionin standard të përcaktuar në këtë nen.

Ky informacion standard duhet të jepet në mënyrë të qartë, të saktë dhe të dukshme, me anë të një shembulli përfaqësues, ku të specifikohen:

- a) norma e huas, fikse ose të ndryshueshme, ose të dyja së bashku, me veçoritë e çdo pagese/detyrimi të përfshira në koston totale të kredisë për konsumatorin;
- b) shuma totale e kredisë;
- c) norma vjetore e përqindjes së pagesave/detyrimeve apo norma efektive e interesit (NEI), siç përcaktohet me akt nënligjor të Bankës së Shqipërisë;
- ç) nëse është e zbatueshme, kohëzgjatja e marrëveshjes së kredisë;
- d) në rastin e një kredie në formën e një pagese të shtyrë, për një mall ose shërbim të veçantë, çmimi në para (kesh) dhe shuma e çdo pagese në avancë;
- dh) shuma totale e pagesës për konsumatorin dhe shumat e pagesave për këstet”.

2. Pas pikës 1 shtohen pika 1.1 dhe 1.2 me këtë përmbajtje:

“1.1. Në një kohë të arsyeshme, përpara se konsumatori të pranojë ndonjë ofertë ose të lidhë kontratë, kreditori dhe, kur është e zbatueshme, ndërmjetësuesi i kredisë, i sigurojnë konsumatorit, në bazë të kushteve të kredisë dhe kushteve të ofruara nga kreditori, si dhe nëse është e zbatueshme, preferencave të shprehura apo informacionit të dhënë nga ana e konsumatorit, të dhënat e nevojshme për të krahasuar ofertat e ndryshme, në mënyrë që të marrë, sipas këtyre të dhënave, një vendim për lidhjen e një marrëveshjeje kredie.

Një informacion i tillë, i dhënë me shkrim apo me një mjet tjetër të qëndrueshëm, duhet të jetë sipas formës/formave standarde të informacionit të kredisë konsumatore, të përcaktuar nga Banka e Shqipërisë.

1.2. Në kuptim të këtij neni, “ndërmjetësuesi i kredisë” është çdo person fizik ose juridik, i cili nuk vepron si kreditor, por për qëllime që lidhen me tregtinë, biznesin ose profesionin e tij:

- i) paraqet ose ofron marrëveshje kredie te konsumatorët;
- ii) ndihmon konsumatorët për punën përgatitore, në lidhje me marrëveshjet e kredisë, ndryshe nga ato të përmendura në nënndarjen “i”;
- iii) lidh marrëveshje kredie me konsumatorët në emër të kreditorit, mbi bazën e një tarife, që mund të jetë me para ose me ndonjë formë tjetër financiare, për të cilën është rënë dakord.”.

3. Pas pikës 2 shtohet pika 2.1 me këtë përmbajtje:

“2.1. Konsumatori ka të drejtë, në çdo kohë, të shlyejë plotësisht ose pjesërisht detyrimet e tij, sipas marrëveshjes së kredisë. Në këto raste, konsumatorit i jepet e drejta e reduktimit të koston totale të kredisë, që konsiston në uljen e interesit dhe kostove për periudhën e mbetur të kontratës së kredisë.”.

4. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Marrëveshjet e kredisë hartohen me shkrim ose me një mjet tjetër të qëndrueshëm dhe një kopje e saj u jepet palëve.”.

Neni 16

Në nenin 52 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 2:

a) shkronja “c” ndryshohet si më poshtë:

“c) përfaqësues nga shoqëria civile me përvojë në fushën e ekonomisë, dhe jurisprudencës.”

b) paragrafi pas shkronjës “c” ndryshohet si më poshtë:

“Anëtarët e Komisionit, referuar në shkronjat “a” dhe “b”, janë nëpunës të shërbimit civil, të propozuar nga ministri përkatës.

Kryetari dhe anëtarët e Komisionit emërohen dhe shkarkohen me urdhër të Kryeministrit. Kryetari i Komisionit emërohet ndërmjet dy përfaqësuesve të ministrisë përgjegjëse për fushën e tregtisë dhe duhet të ketë të paktën 3 vjet përvojë pune në fushën e mbrojtjes së konsumatorëve.”.

2. Pas pikës 7 shtohet pika 8 me këtë përmbajtje:

“8. Komisioni harton një raport në fund të çdo viti dhe sa herë që i kërkohet, rreth veprimtarisë së tij dhe e publikon atë në faqen e tij të internetit të ministrisë përgjegjëse për tregtinë.”.

Neni 17

Pas nenit 52 shtohet neni 52/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 52/1

Detyrimi për dhënie informacioni

Tregtarët janë të detyruar të japin, në mënyrë të qartë, të vërtetë e jo të mangët, të gjithë informacionin e kërkuar nga organet zbatuese dhe struktura përgjegjëse për mbrojtjen e konsumatorëve, sipas dispozitave të këtij ligji.”.

Neni 18

Në nenin 56 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1, fjalët “në rast se nuk është parashikuar ndryshe ndërmjet palëve” hiqen.

2. Pas pikës 1 shtohet pika 1.1 me këtë përmbajtje:

“1.1. Ngarkohet ministri, që mbulon tregtinë, për nxjerrjen e udhëzimit për përcaktimin e procedurave të trajtimit të ankesave, të paraqitura në strukturën e parashikuar në shkronjën “a” të pikës 1 të këtij neni.”.

3. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Ngarkohet Këshilli i Ministrave për përcaktimin e kritereve që duhet të përmbushë struktura e parashikuar në shkronjën “dh” të pikës 1 të këtij neni.”.

Neni 19

Në nenin 57 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pikat 1, 2 dhe 3 ndryshohen si më poshtë:

“1. Nga struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut:

a) për shkeljet e dispozitave të parashikuara në nenet 9 pikat 3 dhe 4, 11, 18, me gjobë në masën 100 000 lekë;

b) për shkeljet e dispozitave të parashikuara në nenet 7, 8, 9 pikat 1 dhe 2, 12, 30 e 31, me gjobë në masën 1 për qind të xhiros vjetore të vitit financiar paraardhës, por jo më pak se 200 000 lekë;

c) për mosplotësim të kërkesave të parashikuara në nenin 52/1, me gjobë në masën 300 000 lekë;

2. Nga Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorëve:

a) për shkeljet e dispozitave të parashikuara në nenet 14, 15, 17 shkronja “A”, 22, 24, 32 pika 3, 33, 35, 37, 38, 39 e 43, me gjobë në masën 1 për qind të xhiros vjetore të vitit financiar paraardhës, por jo më pak se 300 000 lekë;

b) për shkeljet e dispozitave të parashikuara në nenet 16, 17 shkronja “B”, 25, 27 pika 4, 28 pika 1, 29, 33/1, 40, 41, 45 e 47, me gjobë në masën 2 për qind të xhiros vjetore të vitit financiar paraardhës, por jo më pak se 500 000 lekë;

c) për shkeljet e dispozitave të parashikuara sipas neneve 9 e 39 (për rastet e praktikave tregtare), me gjobë në masën 100 000 lekë;

ç) për mosplotësim të kërkesave të parashikuara në nenin 52/1, me gjobë në masën 300 000 lekë.

3. Nga institucione të tjera:

Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë: për shkeljen e dispozitës së parashikuar në shkronjën “c” të pikës 1 të nenit 9, me gjobë në masën 100 000 lekë;”.

2. Në pikën 4, fjalët “në pikën 1 të këtij neni” zëvendësohen me fjalët “në këtë nen”.

3. Pas pikës 4 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

“5. Kur Komisioni, në shqyrtimin e kundërvajtjes administrative, konstaton shkaktim dëmi, si pasojë e kundërvajtjes administrative, pas përfundimit të shqyrtimit administrativ, vlerëson edhe masën e dëmit dhe me një vendim të veçantë vendos për shpërblimin e dëmit.

Masa e shpërblimit, si dhe pagesa për vlerësimin e dëmit i ngarkohen subjektit që ka kryer kundërvajtjen administrative.”.

Neni 20

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.7059, datë 27.7.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

LIGJ

Nr.10 445, datë 14.7.2011

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.10 222, DATË 4.2.2010 “PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË LIDHUR NDËRMJET MINISTRISË SË MBROJTJES TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHOQËRISË “EUROCOPTER” PËR FURNIZIMIN ME 5 HELIKOPTERË TË MESËM SHUMËROLËSH”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.10 222, datë 4.2.2010 “Për miratimin e kontratës së lidhur ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë “Eurocopter” për furnizimin me 5 helikopterë të mesëm shumërolësh”, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 2 fjalia e parë ndryshohet si më poshtë:

“Programi i zbatimit të kontratës shtrihet në 5 vite buxhetore dhe përfundon në vitin 2014.”.

Neni 2

Miratimin e disa ndryshimeve në kontratën e lidhur ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë “Eurocopter” për furnizimin me 5 helikopterë shumërolësh, të miratuar me ligjin nr. 10 222, datë 4.2.2010, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.7060, datë 27.7.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

AMENDAMENTI NR.1 I KONTRATËS NR.12/2009

NDËRMJET MINISTRISË SË MBROJTJES TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE EUROCOPTER MBI FURNIZIMIN E PESË (5) HELIKOPTERËVE AS532 AL COUGAR DHE PAJISJET QË I SHOQËROJNË

nënshkruar më 17 dhjetor 2009

Ndërmjet:

MINISTRISË SË MBROJTJES (MM)

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”

Tirana, Albania

E-mail: dmpm@mod.gov

Tel: ++355 4 225 5232

Fax: ++355 4 225 5226

Përfaqësuar sipas rregullave nga:

Shkëlqesia e tij, Ministri i Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë

(Në vijim i referuar si “Autoriteti kontraktues”)

dhe

EUROCOPTER S.A.S.

Me seli kryesore në Aeroport International de Marseille-Provence

13725 MARIIGNANE CEDEX – FRANCE.

Përfaqësuar sipas rregullave nga Dr.Ralf Weber, administrator i klientëve të rëndësishëm për Ballkanin – Eurocopter (referuar në vijim si “Kontraktori”).

Autoriteti kontraktues dhe kontraktori janë referuar gjithashtu si “Pala” ose “Palët”.

duke marrë në konsideratë se:

palët kanë lidhur një kontratë më 17 dhjetor 2009 në lidhje me blerjen nga autoriteti kontraktues dhe dorëzimin nga kontraktori të pesë (5) helikopterëve AS 532 AL Cougar, si dhe pajisjeve shoqëruese (kontrata).

palët bien dakord që të ndryshojnë dispozitat e kontratës (duke përfshirë të gjitha shtojcat, të cilat janë pjesë përbërëse e kontratës) në përputhje me paragrafin e parë të nenit 6.1 të kontratës, i cili parashikon se ndryshimi i kontratës do të jetë i vlefshëm vetëm nëse palët bien dakord me shkrim.

si rrjedhojë, palët lidhin këtë marrëveshje shtesë, si më poshtë:

Neni 1

Amendamentet

Kontrata është amenduar në mënyrën e mëposhtme:

1.1 Paragrafët 4 deri 7 të nenit 11.1 “Të përgjithshme” zëvendësohen nga paragrafët vijues:

Një kredi dokumentare e parë do të hapet me urdhër të Blerësit jo më vonë se data 15 qershor 2011, për shumën prej 8,000,000.00 (tetë milionë) eurosh, në mënyrë që të mbulohet pagesa, sipas kërkesës, e pagesave të dyta mbi ecurinë e punës (neni 11.3). Kjo kredi dokumentare do të jetë e vlefshme deri më 31 dhjetor 2011.

Një kredi dokumentare e dytë do të hapet me urdhër të Blerësit jo më vonë se data 28 shkurt 2012, për shumën prej 20,000,000.00 (njëzet milionë) eurosh, në mënyrë që të mbulohet pagesa, sipas kërkesës, e pagesës së mbetur të helikopterit të parë dhe të dytë (nenet 11.4.1 dhe 11.4.2). Kjo kredi dokumentare do të jetë e vlefshme deri më 31 dhjetor 2012.

Një kredi dokumentare e tretë do të hapet me urdhër të Blerësit jo më vonë se data 28 shkurt 2013, për shumën prej 20,600,000.00 (njëzet milionë e gjashtëqind mijë) eurosh, në mënyrë që të mbulohet pagesa, sipas kërkesës, e pagesës së mbetur të helikopterit të tretë dhe të katërt (nenet 11.4.3 dhe 11.4.4). Kjo kredi dokumentare do të jetë e vlefshme deri më 30 korrik 2013.

Një kredi dokumentare e katërt do të hapet me urdhër të Blerësit jo më vonë se data 28 shkurt 2014 për shumën prej 8,570,788.00 (tetë milionë e pesëqind e shtatëdhjetë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e tetë) eurosh, në mënyrë që të mbulohet pagesa, sipas kërkesës, e pagesës së mbetur të helikopterit të pestë (neni 11.4.5). Kjo kredi dokumentare do të jetë e vlefshme deri më 30 qershor 2014.

1.2 Neni 11.3 “Pagesa e ndërmjetme” zëvendësohet plotësisht si më poshtë:

11.3.1 Pagesa e ecurisë së punës, e pagueshme në prill 2011:

Një shumë prej 7,600,000.00 (shtatë milionë e gjashtëqind mijë) eurosh duhet të jetë e pagueshme ndaj Shitësit nëpërmjet një transferte bankare, në momentin e raportit të ecurisë së punës të 4114

përshkruar në aneksin 10, por jo më vonë se data 15 prill 2011, kundrejt paraqitjes nga Shitësi në bankën konfirmuese të një fature tregtare, të një origjinali plus dy kopje të lëshuara nga Shitësi për shumën korresponduese dhe një kopje të certifikatës së ecurisë të punës, në përputhje me aneksin 10.

Nëse Blerësi nuk dërgon njerëzit për inspektimin e ecurisë së punës, në përputhje me aneksin 10, pa ndonjë justifikim brenda tridhjetë (30) ditësh pas dërgimit të njoftimit të ftesës nga shitësi, ky njoftim i ftesës dhe certifikata e ecurisë së punës, të nënshkruara vetëm nga Shitësi do të jenë dokumente që do t'i paraqiten bankës për pagesë.

11.3.2 Pagesa e ecurisë së punës, e pagueshme në tetor 2011:

Një shumë prej 8,000,000.00 (tetë milionë) eurosh duhet të jetë e pagueshme ndaj Shitësit nëpërmjet një kredie dokumentare, sipas kërkesës, në momentin e raportit të ecurisë së punës të përshkruar në aneksin 10, por jo më vonë se data 30 tetor 2011, kundrejt paraqitjes nga Shitësi në bankën konfirmuese, të një fature tregtare në një origjinal plus dy kopje të lëshuara nga Shitësi për shumën korresponduese dhe një kopje të certifikatës së ecurisë së punës të përshkruar në aneksin 10.

Nëse Blerësi nuk dërgon njerëzit e tij për inspektimin e ecurisë së punës, në përputhje me aneksin 10, pa ndonjë justifikim brenda tridhjetë (30) ditësh pas dërgimit të njoftimit të ftesës nga Shitësi, ky njoftim i ftesës dhe certifikata e ecurisë së punës, të nënshkruara vetëm nga Shitësi do të jenë dokumente që do t'i paraqiten bankës për pagesë.

1.3 Neni 11.4 “Pagesat e mbetura” do të zëvendësohet plotësisht me sa më poshtë:

11.4.1 Pagesa e mbetur e helikopterit të parë

Një shumë prej 12,000,000.00 (dymbëdhjetë milionë) eurosh duhet të jetë e pagueshme ndaj Shitësit nëpërmjet një kredie dokumentare, sipas kërkesës, pas uljes së helikopterit të parë në Tiranë, Aeroporti Ndërkombëtar i Rinasit, kundrejt paraqitjes nga Shitësi në bankën konfirmuese, të:

A. Faturës tregtare në një origjinal plus dy kopje të lëshuara nga Shitësi;

B. Një fotokopje të certifikatës ose deklaratës së përputhshmërisë, të lëshuar nga “Eurocopter” për helikopterin e parë;

C. Protokollit të pranimit dhe të transferimit të pronësisë lëshuar nga “Eurocopter” për helikopterin e parë;

D. Deklaratës së uljes (deklarata e uljes) në përputhje me modelin e bashkëlidhur në aneksin 8.

11.4.2 Pagesa e mbetur e helikopterit të dytë

Një shumë prej 8,000,000.00 (tetë milionë) eurosh duhet të jetë e pagueshme ndaj Shitësit nëpërmjet një kredie dokumentare, sipas kërkesës, pas uljes së helikopterit të dytë në Aeroportin Ndërkombëtar të Rinasit, Tiranë, kundrejt paraqitjes nga Shitësi në bankën konfirmuese, të:

A. Faturës tregtare në një origjinal plus dy kopje të lëshuara nga Shitësi;

B. Një fotokopjeje të certifikatës ose deklaratës së përputhshmërisë të lëshuar nga “Eurocopter” për helikopterin e dytë;

C. Protokollit të pranimit dhe të transferimit të pronësisë, i lëshuar nga “Eurocopter” për helikopterin e dytë;

D. Deklaratës së uljes (deklarata e uljes) në përputhje me modelin e bashkëlidhur në aneksin 8 të kontratës.

11.4.3 Pagesa e mbetur e helikopterit të tretë

Një shumë prej 10,600,000.00 (dhjetë milionë e gjashtëqind mijë) eurosh duhet të jetë e pagueshme ndaj Shitësit nëpërmjet një kredie dokumentare, sipas kërkesës, pas uljes së helikopterit të tretë në Aeroportin Ndërkombëtar të Rinasit, Tiranë, kundrejt paraqitjes nga Shitësi në bankën konfirmuese, të:

A. Faturës tregtare në një origjinal plus dy kopje të lëshuara nga Shitësi;

B. Një fotokopje të certifikatës ose deklaratës së përputhshmërisë të lëshuar nga “Eurocopter” për helikopterin e tretë;

C. Protokollit të pranimit dhe të transferimit të pronësisë, të lëshuar nga “Eurocopter” për helikopterin e tretë;

D. Deklaratës së uljes (deklarata e uljes) në përputhje me modelin në aneksin 8 të kontratës.

11.4.4 Pagesa e mbetur e helikopterit të katërt

Një shumë prej 10,000,000.00 (dhjetë milionë) eurosh, duhet të jetë e pagueshme ndaj Shitësit nëpërmjet një kredie dokumentare, *at sight*, pas uljes së helikopterit të katërt në Tiranë, Aeroporti Ndërkombëtar i Rinasit, kundrejt paraqitjes nga Shitësi në bankën konfirmuese të:

A. Faturës tregtare në një origjinal plus dy kopje të lëshuara nga Shitësi;

B. Një fotokopje të certifikatës ose deklaratës e përputhshmërisë të lëshuar nga “Eurocopter” për helikopterin e katërt;

C. Protokollit të pranimit dhe transferimit të pronësisë, të lëshuar nga “Eurocopter” për helikopterin e katërt;

D. Deklaratën e uljes (deklarata e uljes) në përputhje me modelin e bashkëlidhur në aneksin 8 të kontratës.

11.4.5 Pagesa e mbetur e helikopterit të pestë

Një shumë prej 8,570,788.00 (tetë milionë e pesëqind e shtatëdhjetë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e tetë) eurosh duhet të jetë e pagueshme ndaj Shitësit nëpërmjet një kredie dokumentare, sipas kërkesës, pas uljes së helikopterit të pestë në Aeroportin Ndërkombëtar të Rinasit, Tiranë, kundrejt paraqitjes nga Shitësi në bankën konfirmuese, të:

A. Faturës tregtare në një origjinal plus dy kopje të lëshuara nga Shitësi;

B. Një fotokopje të certifikatës ose deklaratës së përputhshmërisë të lëshuar nga “Eurocopter” për helikopterin e pestë;

C. Protokollit të pranimit dhe transferimit të pronësisë, të lëshuar nga “Eurocopter” për helikopterin e pestë;

D. Deklaratës së uljes (deklarata e uljes) në përputhje me modelin e bashkëlidhur në aneksin 8 të kontratës.

1.4 Paragrafi 3 i nenit 11.5.1 “Formulari i garancisë” do të zëvendësohet plotësisht si më poshtë:

Garancia kontraktuale do të hyjë në fuqi prej datës së hyrjes në fuqi të kontratës, e cila do t’i njoftohet Bankës nga Shitësi menjëherë pas marrjes së paradhënies së parë (neni 11.2.1) dhe do të bëhet e vlefshme brenda 30 ditëve nga data e dorëzimit të helikopterit të fundit/ose jo më vonë se data 31 maj 2014.

1.5 Paragrafi 1 deri në paragrafin 4 (17 rreshtat e parë) të nenit 12.2 “Datat e dorëzimit” do të zëvendësohen si më poshtë:

Helikopterët do të dorëzohen si më poshtë dhe sipas konfigurimit të përcaktuar në aneksin 1 të këtij amendamenti:

Konfigurimi VIP	26.3.2012
Konfigurimi CSAR	26.10.2012
Konfigurimi MEDEVAC	31.3.2013
Konfigurimi TTH	30.7.2013
Konfigurimi TTH	30.4.2014

1.6 Aneksi 1 “Konfigurimi i helikopterit” është ndryshuar sipas aneksit 1 të këtij amendamenti.

1.7 Paragrafi i parë i “2. Inspektimi i parë i progresit të punës” të aneksit 10 “Inspektimi i progresit të punës” do të zëvendësohet sa më poshtë:

Inspektimi i parë i progresit të punës do të zhvillohet jo më vonë se data 15 prill 2011, në Marignane, Francë, tek ambientet e Shitësit.

1.8 Paragrafi i parë i “3. Inspektimi i dytë i progresit të punës” të aneksit 10 “Inspektimi i progresit të punës” do të zëvendësohet sa më poshtë:

Inspektimi i dytë i progresit të punës do të zhvillohet jo më vonë se data 10 tetor 2011, në Marignane, Francë, tek ambientet e Shitësit.

Neni 2 Të ndryshme

Të gjitha klauzolat dhe përkufizimet e shprehura në kontratën kryesore, mbeten të vlefshme dhe të pandryshuara për amendamentin, përveç kur përcaktohet sa më sipër.

Ky amendament është hartuar në dy variante, një në anglisht dhe një në shqip (përveç anekseve që do të hartohen vetëm në anglisht).

Në rast mosmarrëveshjeje ndërmjet palëve, varianti në anglisht do të ketë përparësi.

Ky amendament kontrate hyn në fuqi pas nënshkrimit nga të dyja palët.

Në dëshmi të kësaj, ky amendament është ekzekutuar nga përfaqësuesi i autorizuar i secilës palë dhe do të hyjë në fuqi pasi të jetë ratifikuar.

_____/_____/2011 _____/_____/2011
Vendi dhe data Vendi dhe data

Për dhe në emër të:
AUTORITETIT KONTRAKTUES

Shkëlqesia e tij Arben Imami
Titulli: Ministër i Mbrojtjes i Republikës së
Shqipërisë

Për dhe në emër të:
KONTRAKTORIT

Dr. Ralf Weber
Titulli: Administrator i Klientëve të
Rëndësishëm

LIGJ
Nr.10 446, datë 14.7.2011

**PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË LIDHUR NDËRMJET MINISTRISË SË MBROJTJES TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE “EUROCOPTER” PËR FURNIZIMIN ME 1 (NJË)
HELIKOPTER EC 145 VIP**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Miratohet kontrata e lidhur ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë dhe “Eurocopter” për furnizimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë me 1 (një) helikopter EC 145 VIP, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Programi i zbatimit të kontratës shtrihet në 2 vite buxhetore dhe përfundon brenda vitit 2012. Ministria e Mbrojtjes të marrë masat për planifikimin e fondeve përkatëse për ekzekutimin e kontratës.

Neni 3

Ministria e Mbrojtjes të përzgjedhë dhe të negociojë me bankën e pranuar edhe nga “Eurocopter” për mënyrat e kryerjes së pagesave me anë të letërkreditit.

Neni 4

Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga ky ligj dhe nga kontrata.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.7061, datë 27.7.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

KONTRATË

NDËRMJET MINISTRISË SË MBROJTJES SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE EUROCOPTER PËR FURNIZIMIN ME (1) HELIKOPTER EC 145 VIP

HYRJE

Kjo kontratë është lidhur më 29 mars 2011 ndërmjet:
MINISTRISË SË MBROJTJES SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”
Tiranë, Shqipëri
E-mail: sek.aviacionit@mod.gov.al
Telefon: ++355 4 225 5232
Fax: ++355 4 225 5226

përfaqësuar rregullisht nga
Shkëlqesia e tij, Ministri i Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë.

- Autoriteti kontraktues
(në vijim i referuar si “Blerësi”)

dhe

EUROCOPTER S.A.S.

Me seli kryesore në

Aeroportin Ndërkombëtar të Marsejës – Provence

13725 MARIGNANE CEDEX -FRANCE

Përfaqësuar rregullisht nga Dr.Ralf Weber, Administrator i Klientëve të Rëndësishëm për
Ballkanin

- Kontraktori

(në vijim i referuar si “Shitësi”)

Shitësi dhe Blerësi referohen, gjithashtu, si “Pala” ose “Palët”

Me anë të kësaj, të dyja palët bien dakord si më poshtë:

A. KUSHTE TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Përkufizimet

Për qëllim të kësaj kontrate (përfshirë anekset), termat e mposhtëm do të kenë kuptimin e përcaktuar në këtë seksion:

1.1 “Kontratë” do të thotë kjo kontratë midis Blerësit dhe Shitësit, duke përfshirë të gjitha nenet, si edhe anekset e listës A dhe listës B të kësaj kontrate.

1.2 “Blerësi” do të thotë autoriteti kontraktues, Ministria e Mbrojtjes së Shqipërisë.

1.3 “Shitësi” do të thotë kontraktori, Eurocopter S.A.S.

1.4 “Furnizimet” do të thotë helikopteri, trajnimi dhe dokumentacioni, të cilat i furnizohen Blerësit nga Shitësi sipas kësaj kontrate.

“Furnizimet” në mënyrë më specifike përfshijnë sipas kontratës:

1.4.1 “Helikopteri” do të thotë helikopteri EC145, siç përcaktohet në konfigurimin teknik në listën B, aneksi 11 “Konfigurimi i helikopterit”.

1.4.2 “Trajnimet” do të thotë trajnimet sipas përshkrimit në nenin 17.

1.4.3 “Dokumentacioni” do të thotë dokumentacioni teknik, siç përkufizohet në nenin 18.

1.5 “Çmimi i kontratës” do të thotë shuma totale për furnizimet e pagueshme nga Blerësi te Shitësi sipas kësaj kontrate në përputhje me nenin 9.

1.6 “Certifikata e përputhshmërisë” ose “Deklarata e përputhshmërisë” do të thotë dokumenti i publikuar nga Organizata e Sigurimit të Cilësisë të Shitësit, pas mbarimit të procedurave të miratuara nga autoritetet përkatëse, i cili vërteton përputhshmërinë e helikopterëve me standardet dhe specifikimet e aplikueshme të prodhuesit, duke përfshirë, por pa u kufizuar në formularin EASA 52.

1.7 “Certifikata e përfundimit” do të thotë dokumenti i lëshuar nga Organizata e Sigurimit të Cilësisë të Shitësit, pas përfundimit të procedurave të miratuara nga autoritetet përkatëse, i cili vërteton

përputhshmërinë e trajnimit dhe dokumentacionit me standardet dhe specifikimet e aplikueshme të prodhuesit.

1.8 “Protokolli i pranimit dhe transferimit të pronësisë” do të thotë protokollin e nënshkruar nga Blerësi pas procedurave të pranimit të fabrikës, me anë të të cilit pranohet që helikopteri është në përputhje me përcaktimet e kontratës.

1.9 “Protokolli përfundimtar i pranimit” do të thotë protokollin e nënshkruar nga Blerësi dhe Shitësi, nëpërmjet të cilit të gjitha rreziqet që lidhen me humbjen ose dëmtimin e furnizimeve kalojnë te Blerësi, siç përshkruhet në nenin 13.5.

1.10 “Data e hyrjes në fuqi të kontratës” ose “DHFK” do të thotë data e marrjes së paradhënies së parë (siç parashikohet në nenin 11.2).

1.11 “Data e dorëzimit” do të thotë data kur certifikata e përputhshmërisë ose deklarata e përputhshmërisë është lëshuar për furnizimet, dhe certifikata e përfundimit është lëshuar për trajnimin dhe dokumentacionin.

1.12 “Vendndodhja e Blerësit” nënkupton Farkë, Tiranë, Shqipëri.

Termat e tjerë me germa kapitale kanë kuptimin e përcaktuar kudo tjetër në kontratë.

Neni 2

Objekti i kontratës

Në bazë të kësaj kontrate të nënshkruar më 29 mars 2011 dhe pasi pagesa e çmimit të kontratës, sipas kushteve të parashikuara në nenin 11 të jetë përmbushur, Shitësi bie dakord të shesë dhe Blerësi bie dakord të blejë sasinë e përcaktuar, si më poshtë:

Një (1) helikopter EC 145 së bashku me publikimin teknik, trajnimin dhe asistencën teknike, bashkërisht të quajtura furnizimet.

Neni 3

Pronësia intelektuale

Shitësi ruan të gjitha të drejtat në lidhje me zhvillimin, shpikjet, procedurat e prodhimit dhe çdo të drejtë të pronësisë intelektuale në lidhje me objektin e kontratës. Kopjimi dhe/ose riprodhimi i furnizimeve ose publikimeve të Shitësit, të plota ose të pjesshme, pa miratimin e Shitësit është i paligjshëm.

Asgjë në këtë kontratë nuk interpretohet si një transferim i ligjshëm i ndonjë patente, pajisjeje ose model dizajnoje, e drejtë autori, marke ose e drejtë e pronësisë intelektuale.

Neni 4

Ligji i zbatueshëm

Kontrata rregullohet nga ligji shqiptar. Pavarësisht nga sa më sipër, dispozitat në lidhje me prodhimin e furnizimeve dhe/ose shërbimeve të tjera të kryera nga Shitësi në Gjermani, rregullohen nga ligji gjerman.

Neni 5

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Palët duhet të përpiqen të zgjidhin miqësisht çdo mosmarrëveshje, kundërshtime apo pretendime që lindin ose në lidhje me kontratën.

Nëse pas dy (2) muajsh pas ndodhjes së kësaj mosmarrëveshjeje, kundërshtimi apo pretendimi, palët nuk arrijnë një marrëveshje, atëherë mosmarrëveshja, kundërshtimi ose pretendimi do të zgjidhet përfundimisht sipas rregullave të arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë nga tre arbitra të caktuar në përputhje me rregullat e lartpërmendura.

Vendi i arbitrazhit do të jetë Gjeneva (Zvicër).

Gjuha e arbitrazhit do të jetë gjuha angleze.

Përveçse kur palët kanë rënë dakord ndryshe, fakti që një mosmarrëveshje i është referuar arbitrazhit, sipas kësaj dispozite, nuk do të lirojë asnjë palë nga detyrimet e tyre, siç është parashikuar në këtë kontratë. Vendimet e arbitrazhit do të jenë përfundimtare dhe detyruese për palët.

Neni 6 Të ndryshme

6.1 TËRËSIA E KONTRATËS DHE NDRYSHIMET

Këto kushte të përgjithshme, së bashku me kushtet e veçanta të parashikuara dhe të pranuar në këtë kontratë, përbëjnë të gjithë marrëveshjen midis Shitësit dhe Blerësit. Ato zëvendësojnë të gjitha komunikimet ose marrëveshjet, me shkrim ose verbale, midis Shitësit dhe Blerësit në lidhje me furnizimet. Çdo ndryshim i kontratës do të jetë i vlefshëm vetëm nëse do të jetë rënë dakord me shkrim nga palët.

Moszbatimi ose mosaplikimi nga ana e Shitësit në çdo kohë të çdo dispozite të kësaj kontrate, nuk interpretohet në asnjë mënyrë si heqje dorë, në të tashmen ose në të ardhmen, nga zbatimi i një dispozite të tillë ose as si ndonjë mënyrë që cenon vlefshmërinë e kësaj kontrate apo ndonjë pjesë të saj ose të drejtën e Shitësit që pas kësaj të zbatojë çdo dispozitë të tillë.

Në rast se një ose më shumë dispozita të parashikuara në këtë kontratë çmohen të pavlefshme ose të pazbatueshme, pjesët e tjera mbeten plotësisht të vlefshme dhe të zbatueshme. Dispozitat e pavlefshme ose të pazbatueshme zëvendësohen me dispozita të tjera, të cilat përmbushin qëllimin ekonomik dhe ligjor të dispozitave që konsiderohen të pavlefshme për aq sa kjo është e mundur.

6.2 KONFIDENCIALITETI

Blerësi dhe Shitësi pranojnë konfidencialitetin dhe natyrën e pronësisë mbi dokumentet dhe informacionin e parashikuar në të në lidhje me furnizimet. Përveç rasteve kur është rënë dakord me shkrim më parë, Blerësi nuk duhet të kopjojë apo publikojë asnjë informacion të marrë në mënyrë direkte ose të tërthortë gjatë dhe pas zbatimit të kësaj kontrate.

Në rast se shkelet konfidencialiteti, Shitësi dhe Blerësi kanë të drejtë të pretendojnë kompensim nga dhe kundrejt palës që ka përhapur informacionin.

6.3 GJUHA

Kontrata është shkruar në dy versione, një në anglisht dhe një në shqip (me përjashtim të anekseve që do të shkruhen vetëm në anglisht).

Në rast mosmarrëveshjeje midis palëve, versioni në anglisht do të ketë përparësi.

Të dyja palët do të përdorin gjuhën angleze për shkëmbim informacioni dhe njoftime sipas nenit 8.

Neni 7 Transferimi

Pa pëlqimin paraprak me shkrim të Shitësit, Blerësi nuk mund t'i kalojë ose transferojë një palë të tretë një pjesë ose të gjitha të drejtat dhe detyrimet që parashikohen në këtë kontratë.

Neni 8 Korrespondenca

I gjithë komunikimi, korrespondenca, raportet ndërmjet palëve do të jenë në anglisht, me konfirmim marrjeje.

Të gjitha komunikimet do t'i drejtohen:

SHITËSI:
MARRËDHËNIET ME KLIENTIN DHE SHITJET

Adresa: EUROCOPTER S.A.S.
c/o EUROCOPTER DEUTSCHLAND GmbH
D-86607 DONAUWÖRTH
GERMANY

Në vëmendje të: Dr.Ralf WEBER
Tel: +49 906 71 3499
Telefaks: +49 906 71 4078
E-mail: Ralf.weber@eurocopter.com

MENAXHIMI I PROGRAMIT

Adresa: EUROCOPTER S.A.S.
c/o EUROCOPTER DEUTSCHLAND GmbH
D-86607 DONAUWÖRTH
GERMANY

Në vëmendje të: Z. Yves KLAUER
Tel.: +49 906 71 3729
Faks: +49 906 71 4099
E-mail: Yves.Klauer@eurocopter.com

BLERËSI:

Adresa: Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Shqipërisë, Drejtoria e Modernizimit

Bulevardi: “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë, Shqipëri
Në vëmendje të: Drejtorit të Drejtorisë së Modernizimit
Tel: + 355 4 225 52 32
Telefaks: + 355 4 225 52 26
E-mail: sek.aviacionit@mod.gov.al

B. KUSHTET E VEÇANTA

Neni 9 Çmimi

9.1 ÇMIMI I KONTRATËS

Një (1) helikopter EC 145 i porositur përfundimisht duhet të dorëzohet DDU (DDU, sipas botimit INCOTERMS 2000) në Farkë, Tiranë, Shqipëri, i papaketuar.

Nr.	Emërtimi	Njësia matëse	Sasia	Fondi limit për prokurimin pa TVSH (në euro)
1.	Blerje e helikopterit VIP sipas konfigurimit të përshkruar në aneksin teknik	Copë	1	5,350,000.00
2.	Trajnimi i pilotëve	Persona/kohë	2 pilotë / 10 ditë	Është përfshirë në çmimin e helikopterit
3.	Trajnimi i teknikëve - Trajnim në strukturë për helikopterin për 2 (dy) teknikë mirëmbajtjeje. - Trajnim i tipit helikopter avionics për 1 (një) teknik mirëmbajtje - Trajnim i teknikëve të mirëmbajtjes për motorët e helikopterëve	Persona/kohë	2 persona / 4 javë 1 person / 4 javë 2 persona / 5 ditë	Është përfshirë në çmimin e helikopterit
4.	Asistenca teknike	Persona/kohë	1 person / 2 javë	Është përfshirë në çmimin e helikopterit
5.	Pajisja me dokumente dhe publikime	Komplet	Komplet	Është përfshirë në çmimin e helikopterit
	TOTALI NË EURO			5,350,000.00

Në rast se kjo kontratë nuk do të hyjë në fuqi para datës 31 prill 2011, këto çmime mund të ndryshohen në përputhje me ciklin e ri kohor të dorëzimit dhe kushtet përkatëse financiare.

9.2 ÇMIMI

Çmimi në këtë kontratë është për furnizimet e dorëzuara me DDU (DDU botimi INCOTERM 2000) në Farkë, Tiranë, Shqipëri, të papaketuara, në përputhje me konfigurimin e helikopterit, siç është detajuar në listën B, aneksi 11.

Çmimi i kontratës është në monedhën euro, monedhë që përdoret në llogaritje dhe në pagesa.

Çmimi përfshin të gjitha shpenzimet dhe taksat që lidhen me prodhimin e furnizimeve, pa TVSH.

Ai nuk përfshin asnjë detyrim që rezulton nga rregullat administrative dhe legislative në fuqi në shtetin e Blerësit dhe asnjë detyrim doganor dhe tatimor, të cilat janë përgjegjësi e Blerësit.

Çmimi i referohet furnizimeve të parashikuara shprehimisht në këtë kontratë. Çdo ndryshim konfigurimi dhe/ose çdo furnizim shtesë dhe/ose shërbime që duhet të sigurohen nga Shitësi duhet që më parë të jenë bërë me marrëveshje me shkrim dhe duhet t'i nënshtrohen një amendimi të kontratës, duke përcaktuar çdo ndryshim në çmim dhe/ose në programin e dorëzimit.

Neni 10

Licenca/ autorizime për eksport/ import

Nëse furnizimet dhe/ose shërbimet sipas kontratës kërkojnë autorizim/licencë zyrtare, Shitësi duhet të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme dhe të ndjekë procedurat e duhura për të siguruar këtë licencë/autorizim.

Nëse kërkohet përfshirja e Blerësit, atëherë Blerësi do të ofrojë asistencën e tij pa vonesë.

Nëse një licencë/autorizim i tillë nuk merret dhe/ose merret me vonesë dhe/ose licenca/autorizimi që është marrë është anuluar dhe/ose nëse licenca/autorizimi i marrë nuk është rinovuar, Blerësi nuk ka të drejtë ankimi ndaj Shitësit në lidhje me këtë. Në këtë rast, Shitësi ka të drejtë ta zgjidhë kontratën. Brenda tre muajve nga njoftimi i palës që synon të zgjidhë kontratën, palët duhet të gjejnë një zgjidhje.

Licencat/autorizimet e eksportit zakonisht sigurohen për një përdorim fundor/përdorues fundor të veçantë. Çdo ndryshim në përdorimin fundor/përdoruesin fundor të furnizimeve korresponduese dhe/ose shërbimeve kërkon një autorizim paraprak të qeverive që kanë lëshuar licencat/autorizimet e eksportit të lartpërmendura.

Rrjedhimisht, Blerësi duhet të informojë Shitësin përpara çdo transferimi të kontrollit, zotërimit, regjistrimit, titullit, pronësisë etj., të furnizimeve dhe/ose shërbimeve për një palë të tretë, në mënyrë që të lejojë Blerësin të përcaktojë veprimet e nevojshme që do të merren dhe procedurat që do të zbatohen. Më pas, Blerësi duhet të ndjekë udhëzimet e dhëna nga Shitësi.

Nëse një licencë/autorizim i tillë nuk merret ose merret me vonesë ose licenca/autorizimi i marrë është anuluar, Blerësi nuk ka të drejtë ankimi ndaj Shitësit në lidhje me këtë.

Blerësi duhet të sigurojë personalisht në kohën e duhur çdo licencë/autorizim importi që kërkohet në vendin e tij për furnizimet dhe/ose shërbimet e mbuluara nga kjo kontratë.

Neni 11

Kushtet e pagesës

11.1 TË PËRGJITHSHME

Të gjitha pagesat sipas kësaj kontrate do të bëhen pa u mbajtur tatime, taksa, tarifa, pagesa dhe lloje të tjera detyrimesh.

Monedha e llogaritjes, faturimit dhe pagesës do të jetë në monedhën europiane euro.

Paradhëniet e para sipas nenit 11.2, dhe pagesa për ecurinë e punës sipas nenit 11.3 kryhen nëpërmjet një transferte bankare nga llogaria e Blerësit e përmendur në nenin 11.2.

Pagesa e shumës së mbetur kryhet nëpërmjet (1) një kredie dokumentare të përvokueshme, të patransferueshme dhe të konfirmuar (kredia dokumentare), e cila duhet të jetë pranuar me shkrim nga Shitësi, dhe do të lëshohet si më poshtë, nga një bankë ndërkombëtare e nivelit të parë që ka një degë në Shqipëri. Kjo kredi dokumentare duhet të konfirmohet në favor të Shitësit nëpërmjet një banke ndërkombëtare të nivelit të parë (banka konfirmuese). Banka konfirmuese, gjithashtu, duhet të veprojë si bankë këshilluese dhe bankë paguese.

Kredia dokumentare do të hapet me urdhër të Blerësit jo më vonë se data 1 dhjetor 2011 për shumën prej 3,477,500 (tre milionë e katërqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind) eurosh, me qëllim mbulimin e pagesës në bazë të kërkesës së pjesës së mbetur të pagesës të helikopterit EC 145. Kjo kredi dokumentare do të jetë e vlefshme deri në datën 30 qershor 2012.

Palët bien dakord të përdorin modelin e kredisë dokumentare të bashkëlidhur në aneksin 5.

Në rast se Blerësi nuk hap kredinë dokumentare brenda periudhës së përcaktuar më sipër, çdo vonesë në hapjen e kredisë dokumentare pas datës së përcaktuar më sipër, do të përfshijë të njëjtën periudhë vonese kohore në programin e dorëzimit të përcaktuar në nenin 12.

Nëse kredia dokumentare skadon përpara përfundimit të plotë të dorëzimit të furnizimeve, Blerësi duhet të mundësojë në kohën e duhur zgjatjen e afatit, me kërkesë dhe shpenzimet e Shitësit.

Shitësi mund të kërkojë ndryshime të secilës kredi dokumentare, nëse nuk është në përputhje me dispozitat e kësaj kontrate (përfshirë aneksin 5) dhe Blerësi merr përsipër ndryshimin e kredisë dokumentare me shpenzimet e tij brenda 30 ditësh pas kërkesës së Shitësit.

Të gjitha kreditë dokumentare që sjellin pagesa dhe të gjitha pagesat në lidhje me to, që bëhen në vendin e Blerësit, do të përballohen nga Blerësi dhe të gjitha pagesat që rrjedhin nga vendi i Shitësit, do të përballohen nga Shitësi duke përfshirë dhe pagesat e konfirmimit.

Kreditë dokumentare i nënshtrohen praktikës së njësuar doganore dhe praktikës mbi kreditë dokumentare 2007, publikimi i rishikuar I.C.C. nr.600.

Pagesat do të konsiderohen të përmbushura në momentin që shuma e plotë kreditohet në mënyrë të parevokueshme në llogarinë bankare të “Eurocopter-it” të përmendura sipas kësaj kontrate.

11.2 PARADHËNIA

Brenda dy javësh nga nënshkrimi i kësaj kontrate, Blerësi duhet t'i paguajë Shitësit një paradhënie me shumën 535.000 (pesëqind e tridhjetë e pesë mijë) euro nëpërmjet transfertës në llogarinë bankare të Shitësit, të përmendur sipas kësaj kontrate kundrejt paraqitjes së një fature tregtare në një origjinal, plus dy kopje të lëshuara nga Shitësi për shumën korresponduese.

Emri i bankës: NATIXIS

Numri i llogarisë: Iban: F R 7 6 3 0 0 0 7 5 3 0 3 7 0 4 5 3 2 8 8 7 0 0 0 7 4

Swift Code (BIC): CCBPFRPP926

11.3 PAGESAT E NDËRMJETME

11.3.1 Pagesa e ecurisë së punës e pagueshme jo më vonë se gjashtë (6) muaj pas datës së hyrjes në fuqi të kontratës:

Një shumë prej 1.337.500 eurosh (vetëm një milion e treqind e tridhjetë e shtatë mijë e pesëqind euro) duhet të jetë e pagueshme ndaj Shitësit nëpërmjet një transferte bankare nga llogaria e Shitësit e përmendur në nenin 11.2, me kërkesë, në momentin e raportit të ecurisë së punës të përshkruar në aneksin 9, por jo më vonë se 1 tetori 2011, kundrejt paraqitjes nga Shitësi të një fature tregtare në një origjinal, plus dy kopje të lëshuara nga Shitësi për shumën korresponduese dhe një kopje të certifikatës së ecurisë së punës në përputhje me aneksin 9.

Nëse Blerësi nuk dërgon njerëzit e tij për inspektimin e ecurisë së punës, në përputhje me aneksin 9, pa ndonjë justifikim brenda tridhjetë (30) ditësh pas dërgimit të njoftimit të ftesës nga Shitësi, një njoftim i tillë i ftesës dhe certifikatës së ecurisë së punës, të nënshkruara vetëm nga Shitësi, do të jenë dokumentet që do t'i paraqiten Blerësit për pagesë.

11.3.2 PAGESAT E MBETURA

Një kredi dokumentare do të hapet me urdhër të Blerësit jo më vonë se data 1 dhjetor 2011 për shumën prej 3,477,500 (tre milionë e katërqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind) eurosh, me qëllim mbulimin e pagesës në bazë të kërkesës, të pjesës së mbetur të pagesës së helikopterit EC 145. Kjo kredi dokumentare do të jetë e vlefshme deri në datën 30 qershor 2012.

Kjo shumë do të jetë e pagueshme ndaj Shitësit, pas uljes së helikopterit EC 145 në Aeroportin Ndërkombëtar të Rinasit, Tiranë, kundrejt paraqitjes nga Shitësi pranë Bankës Konfirmuese të:

- a) faturës tregtare në një origjinal, plus dy kopje të lëshuara nga Shitësi;
- b) një fotokopje e certifikatës së përputhshmërisë ose deklaratës së përputhshmërisë lëshuar nga “Eurocopter” Gjermani për helikopterin EC 145;
- c) pranimit dhe transferimit të protokollit të pronësisë, lëshuar nga “Eurocopter”, ose protokollin e pranimit;
- d) deklaratës së uljes (deklarata e uljes) në përputhje me modelin e bashkëlidhur në aneksin 8 të kontratës.

11.4 GARANCIA BANKARE

11.4.1 FORMULARI I GARANCISË

Në mënyrë që të garantohet përmbushja e kontratës, duhet të lëshohet një formular garancie në favor të Blerësit me shumën 535.000,00 (pesëqind e tridhjetë e pesë mijë) euro që përfaqësojnë dhjetë për qind (10 %) të shumës totale të kontratës.

Ky formular garancie do të lëshohet në formën e një garancie kontraktuale nga një bankë ndërkombëtare e nivelit të parë në Francë.

Garancia kontraktuale do të bëhet efektive në datën e hyrjes në fuqi të kontratës, e cila do t'i njoftohet bankës nga Shitësi menjëherë pas marrjes së paradhënies së parë (neni 11.2) dhe do të jetë e vlefshme deri në 30 ditë pas ditës së dorëzimit të helikopterit ose jo më vonë se data 31 mars 2012.

Garancia kontraktuale i nënshtrohet rregullave të njësuara të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë për kërkesë garancitë, publikimi nr.758, i cili do të jetë detyrues për palët, me përjashtim të rastit kur nuk është në përputhje me kushtet e përcaktuara në këtë kontratë.

Një model i kësaj garancie kontraktuale tregohet në aneksin 6.

11.4.2 GARANCIA BANKARE

Shitësi do të lëshojë një garanci bankare në shumën prej 1,000,000.00 (vetëm një milion) eurosh në favor të Blerësit (garancia bankare).

Kjo garanci bankare do të lëshohet nga një bankë ndërkombëtare e nivelit të parë në Francë, jo më vonë se pesë (5) muaj pas datës së hyrjes në fuqi të kontratës.

Garancia bankare do të jetë e vlefshme nga data e marrjes në llogarinë e Shitësit të pagesës mbi ecurinë e punës, datë që do t'i njoftohet bankës nga Shitësi menjëherë pas marrjes së pagesës mbi ecurinë e punës deri më 30 qershor 2012.

Kjo garanci bankare i nënshtrohet rregullave të njësuara të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë për kërkesë garancitë, publikimi nr.758, i cili do të jetë detyrues për palët, me përjashtim të rastit kur nuk është në përputhje me kushtet e përcaktuara në këtë kontratë.

Një model i garancisë bankare tregohet në aneksin 7.

Neni 12

Dorëzimi

12.1 TË PËRGJITHSHME

Helikopteri duhet të dorëzohet me DDU, me transport ajror (botimi i DDU INCOTERM 2000) në Farkë, Tiranë, Shqipëri, i papaketuar.

Shitësi mund të kryejë teste fluturimi pas prodhimit dhe fluturime inspektimi në helikopterin e Blerësit, duke mos tejkaluar njëzet (20) orë fluturim.

Orë shtesë fluturimi mund të zhvillohen në rast se Blerësi ka kërkuar zhvillimin dhe instalimin e pajisjeve specifike.

12.2 DATAT E DORËZIMIT

Helikopteri do të dorëzohet në përputhje me konfigurimin e caktuar në listën B, aneksi 11 në vijim dhe, siç deklarohet më poshtë, me kusht që kontrata të hyjë në fuqi përpara datës 31 prill 2011:

Helikopteri do të dorëzohet në përputhje me konfigurimin e përmendur në listën B, aneksi 11 të këtij amendamenti. Data e dorëzimit, e përmendur më poshtë, jepet në muaj kalendarikë dhe T0 përfaqëson datën në të cilën kontrata hyn në fuqi në kohën e marrjes së paradhënies.

Data e dorëzimit tregohet për njësi të dorëzuar Ex-Works (Incoterms – ICC 2000), Doanuwörth, Gjermani.

Koha e dorëzimit për helikopterët në fjalë është: T0 + 12 muaj

Pas dorëzimit të Ex-Works në Donauwörth, Gjermani, Shitësi do të transportojë helikopterin EC145 sipas kushteve DDU (Incoterms – ICC 2000) nëpërmjet fluturimit në Farkë, Tiranë, Shqipëri.

Data e dorëzimit do të jetë data kur lëshohet certifikata e përputshmërisë ose deklarata e përputshmërisë.

Pas pranimit teknik në Donauwörth, Gjermani, helikopteri do të dorëzohet nëpërmjet transportit ajror DDU (Incoterms – ICC 2000), me kusht që të mos ketë vonesa të shkaktuara nga Blerësi, nga Donauwörth, Gjermani në Tiranë, Shqipëri, brenda një muaji nga data e dorëzimit.

Me përjashtim të rasteve kur është përcaktuar ndryshe, çdo datë dorëzimi e shënuar si një muaj kalendarik pa një datë të përcaktuar, do të jetë dita e fundit e punës së atij muaji.

Respektimi i datës së dorëzimit është i kushtëzuar nga përmbushja e detyrimeve kontraktuale të Blerësit, në mënyrë të veçantë në lidhje me detyrimet e Blerësit për të hapur në mënyrë të rregullt kredinë vjetore dokumentare sipas nenit 11 dhe nga respektimi i datave të pagesave të parashikuara në nenin 11 nga Blerësi.

Furnizimet do të mbeten të siguruara nga Shitësi ndaj rreziqeve të dëmtimit dhe zjarrit në tokë deri në momentin e nënshkrimit të protokollit të pranimit.

12.3 VONESAT

12.3.1 SHTYRJA

Çdo vonesë e Blerësit në datat e pagesave, siç përcaktohen në nenin 11, përfshin të njëjtën periudhë kohore vonese në programin e dorëzimit, të përshkruar në nenin 12.2.

12.3.2 FORCA MADHORE

Palët nuk mbajnë përgjegjësi për dështimin në përmbushjen ose në vonesat e përmbushjes së detyrimeve kontraktuale të kësaj kontrate, nëse këto dështime apo vonesa vijnë si pasojë të ngjarjeve të paparashikueshme përtej kontrollit të tyre të arsyeshëm, duke përfshirë, por duke mos u kufizuar në forca madhore, luftë, kryengritje, epidemi, sabotime, greva, largime nga puna në formë protestash, zjarre, shpërthime, mungesa në materiale ose energji, veprime, urdhra ose prioritete të çdo qeverie dhe embargoje.

Pala e penguar duhet të informojë palën tjetër rreth ndodhjes së ndonjë ngjarjeje të forcës madhore brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga koha e fillimit, duke e cituar këtë paragraf në njoftimin e sipërpërmendur. Në një rast të tillë, datat e dorëzimit kontraktual do të shtyhen me një periudhë kohore të arsyeshme që kërkohet për eliminimin e shkaqeve të vonesave.

Nëse një palë pengohet nga një ngjarje e forcës madhore për më shumë se gjashtë (6) muaj pas datës së dorëzimit kontraktual, çdo palë ka të drejtë të zgjidhë kontratën në përputhje me nenin 21.

12.3.3 VONESA E JUSTIFIKUESHME

Çdo shtyrje e datës së dorëzimit nga shkaqet e mëposhtme nuk do të konsiderohet si vonesë në dorëzim:

- ndryshimet ose shtesat në kontratë të kërkuara nga Blerësi pas nënshkrimit të kontratës; ose
- çdo dështim nga Blerësi për të përmbushur detyrimet në përputhje me këtë kontratë; ose
- çdo rast i forcës madhore sipas pikës 12.4.2.

Për më tepër, çdo kosto shtesë e shkaktuar nga Shitësi si rezultat i një pune ose riprogramimit të instalimit të pajisjeve të dhëna Blerësit, për shkak të dështimit të Blerësit për të dorëzuar pajisje plotësisht operacionale dhe të përshtatshme në kohën e duhur, do t'i faturohet dhe do të paguhet nga Blerësi mbi dhe në tejkallim të çmimit të kontratës.

Neni 13

Procedura e pranimit

13.1 PROTOKOLLI I PRANIMIT

Përkatësisht, 1 (një) muaj përpara datës në të cilën helikopteri duhet të jetë gati për inspektim dhe pranimit nga ana e Blerësit, Shitësi do t'i sigurojë Blerësit një plan të saktë, një program dorëzimi dhe procesin për inspektim.

Informacione personale të kërkuara nga përfaqësuesit e Blerësit, në mënyrë që të pranohen në ambientet e Shitësit në Donauwörth, Gjermani, do të përcillen nga Blerësi te Shitësi në këtë kohë. Për më tepër, Blerësi ka të drejtë të përcaktojë deri në (5) pesë pjesëmarrës nga ndonjë palë e tretë, në mënyrë që të ndihmojë gjatë procedurës së pranimit, me kusht që emrat dhe të dhënat e pjesëmarrësve t'i jenë njoftuar pesëmbëdhjetë (15) ditë më parë Shitësit me shkrim. Shitësi rezervon të drejtën të refuzojë çdo pjesëmarrës për arsye të justifikuara.

Me përmbushjen e kënaqshme të procedurave të sigurimit të cilësisë së Shitësit, të miratuara nga autoritetet përkatëse, departamenti i cilësisë së Shitësit do të lëshojë një dokument që vërteton përputhshmërinë e helikopterit (certifikata e përputhshmërisë apo deklarata e përputhshmërisë).

Duke filluar nga data e lëshimit të këtij dokumenti, helikopteri do të konsiderohet i gatshëm për pranimit nga Blerësi.

Me përjashtim të rastit të konstatimit të ndonjë devijimi thelbësor gjatë inspektimit të pranimit, Blerësi duhet të pranojë furnizimet si të ishin në përputhje me specifikimet kontraktuale. Pranimit bëhet me anë të nënshkrimit nga Blerësi të protokollit të pranimit sipas aneksit 2 (protokolli i pranimit).

Blerësi do të përballojë shpenzimet dhe kostot e tij të lidhura me procedurën e pranimit, duke përfshirë, por duke mos u kufizuar në ato të lidhura me qëndrimin e përfaqësuesve të tij gjatë procesit. Nëse procedurat e pranimit shtyhen për faj të Shitësit, Shitësi do të përballojë kostot e arsyeshme shtesë të Blerësit në lidhje me ditët shtesë.

13.2 FLUTURIMET E PRANIMIT NGA BLERËSI

Gjatë procedurës së pranimit, Blerësi mund të kryejë pa pagesë fluturime pranimi gjatë një kohe të kombinuar që nuk duhet të tejkalojë:

- Një (1) orë.

Fluturimet e pranimit do të respektojnë formatin dhe procedurat e parashikuara nga Shitësi dhe do të kryhen nën përgjegjësinë e pilotit të Shitësit që vepron si pilot në komandim.

Blerësi do të jetë i vetmi përgjegjës për personelin e tij, si për dëmtimet që ata mund të pësojnë dhe që ata mund t'i shkaktojnë një pale të tretë, me përjashtim të rastit kur dëmtimi është rezultat i sjelljes qëllimisht të gabuar ose të neglizhencës flagrante të Shitësit.

13.3 TRANSFERIMI I PRONËSISË

Transferimi i pronësisë së helikopterëve do të kryhet në ambientet e Eurocopter në Donauwörth, Gjermani pas pranimit dhe do të materializohet nëpërmjet nënshkrimit të protokollit të pranimit dhe transferimit të pronësisë siç parashikohet në aneksin 3.

13.4 VONESAT E BLERËSIT NË PRANIM

Nëse brenda tridhjetë (30) ditëve pasi helikopteri të jetë gati për pranim, Blerësi dështon të marrë pjesë në pranimin e helikopterit pa ndonjë arsye dhe justifikim me shkrim, pronësia do t'i mbetet Shitësit derisa të plotësohen detyrimet kontraktuale nga Blerësi. Të gjitha shpenzimet që lidhen me këtë, si: magazinimi, mirëmbajtja dhe sigurimi do t'i transferohen dhe faturohen Blerësit.

13.5 TRANSFERIMI I RREZIKUT

Transferimi i rrezikut i helikopterit do të kryhet jo më vonë se një muaj nga data e dorëzimit në vendndodhjen e Blerësit, pas transportit ajror të helikopterit nga Donauwörth, Gjermani, sipas DDU Incoterms 2000.

Një protokoll përfundimtar pranimi do të nënshkruhet nga palët në vendndodhjen e Blerësit brenda dyzetë e tetë (48) orëve, duke filluar nga mbërritja e furnizimeve në vendndodhjen e Blerësit.

Në rast se Blerësi ka kërkuar trajnim shtesë për pilotë pas pranimit të helikopterit, afati prej një muaji, i parashikuar në paragrafin e parë të këtij neni 13.5, do të zgjatet për aq kohë sa duhet për trajnimin e pilotit(ëve) të helikopterit.

Nëse Blerësi dështon në përmbushjen e protokollit përfundimtar të pranimit brenda kohës së lartpërmendur, çdo shpenzim i bërë nga Shitësi për sigurimin do t'i paguhet Shitësit nga Blerësi.

Neni 14

Modifikimet, ndryshimet në furnizim

14.1 MODIFIKIMET E INKORPORUARA PËRPARA DORËZIMIT TË FURNIZIMEVE

Furnizimet do të prodhohen në përputhje me konfigurimin e prodhimit aktual të Shitësit për modelin e helikopterit të zgjedhur. Ndryshimet e konfigurimit mund të bëhen në çdo kohë nga Shitësi, me qëllim që të pajtohen me rregullat e çdo autoriteti kombëtar përkatës.

Për më tepër, Shitësi mund të kryejë modifikime të furnizimeve, sipas kërkesave të reja të prodhimit dhe inxhinierike, pa miratimin e Blerësit, me kusht që modifikimet të mos cenojnë dukshëm performancën e helikopterit, çmimin kontraktual ose kohën e dorëzimit. Rrjedhimisht, Blerësi duhet të informohet. Nëse modifikimet ndikojnë dukshëm në performancën e helikopterit, shpenzimet përkatëse dhe kohën e dorëzimit, Shitësi do të konsultohet me Blerësin për të arritur një marrëveshje mbi pasojat ndaj kontratës.

Çdo ndryshim i konfigurimit, i kërkuar nga Blerësi i nënshtrohet amendimit të kësaj kontrate me anë të miratimit me shkrim nga të dyja palët, si dhe i përshtatjes së çmimit total të furnizimeve, pagesave të kërkuara dhe afateve të dorëzimit.

14.2 MODIFIKIMET PASUESE TË PËRCAKTUARA NË DORËZIMIN E FURNIZIMEVE

Shitësi do të informojë Blerësin për çdo modifikim që Agjencia Kompetente Qeveritare e Gatishmërisë për Fluturim Kombëtar ka vendosur për helikopterët e të njëjtit tip. Në këtë rast, për të tilla modifikime, Shitësi duhet të bëjë të disponueshme për Blerësin, në një kohë të arsyeshme, në bazë të një kërkesë të Blerësit dhe me shpenzime që do të përballohen nga Blerësi, pjesët e këmbimit të kërkuara për të përfshirë modifikime të tilla në helikopter dhe pjesët e këmbimit të dorëzuara më parë.

Për këtë qëllim, Blerësi duhet të marrë pa shpenzime shtesë buletinet me informacion teknik në lidhje me tipin e helikopterit të kësaj kontrate për sa kohë që helikopteri mbetet në shërbim të Blerësit.

Neni 15

Cilësia e produktit dhe dokumentacioni për gatishmërinë e fluturimit

Shitësi zotëron një miratim të organizimit të prodhimit të lëshuar nga autoritetet kombëtare të aviacionit civil përkatës, në përputhje me rregulloren EASA, pjesa 21/G. Privilegjet e një miratimi mbi organizimin e prodhimit përfshijnë lëshimin e dokumenteve të fluturimit.

Shitësi zotëron një certifikatë miratimi të vazhdueshme të Organizatës së Menaxhimit të Gatishmërisë së Fluturimit, të lëshuar nga autoritetet kombëtare të aviacionit civil të tij në përputhje me EASA, pjesa M/nënpjesa G dhe I.

Konfirmimi zyrtar që produktet kanë përbushur procedurat e sigurimit të cilësisë vërtetohet nga lëshimi i dokumenteve të mëposhtme:

- *Për helikopterin(ët) në përkufizimin bazë dhe pajisjet e instaluar opsionale:*
- deklaratë e përputhshmërisë ose certifikatë e përputhshmërisë, lëshuar nga Organizata e Cilësisë së Shitësve për vërtetimin e përputhshmërisë me kërkesat kontraktuale;
- një deklaratë e përputhshmërisë për mjetin e fluturimit (formulari EASA 52) për helikopterët që u janë shitur vendeve anëtare të EASA-s, të nënshkruar nga personeli certifikues i Shitësit brenda miratimit të organizimit të prodhimit të lartpërmendur. Formulari EASA 52 lejon lëshimin nga Autoriteti Kombëtar i Aviacionit Civil të certifikatës së fluturimit për vendet europiane anëtare të EASA-s; ose
- për helikopterët e shitur jashtë Bashkimit Europian, një certifikatë gatishmërie fluturimi për eksport, të lëshuar nga autoriteti kombëtar i aviacionit civil me paraqitjen nga Shitësi përpara përfaqësuesve të lartpërmendur të EASA-s, të deklaratës së përputhshmërisë së fluturimit (formulari EASA 52);
- sipas kërkesës, një certifikatë joregjistrimi të lëshuar nga Autoriteti Kombëtar i Aviacionit Civil.
- *Për pajisjet opsionale të dorëzuara të paketuara dhe pjesët e këmbimit:*
- një certifikatë përputhshmërie ose dokument tjetër i barasvlershëm i lëshuar nga personeli certifikues i autorizuar i Shitësit për komponentë standardë;
- një certifikatë mbi përbushjen e detyrimeve (formulari EASA 1) e lëshuar në emër të Autoritetit Kombëtar të Aviacionit Civil brenda miratimit të lartpërmendur të Organizatës së Prodhimit, për komponentë të tjerë të certifikuar.
- *Për pajisjet dhe instrumentet e ndryshme, të cilat nuk i nënshtrohen instalimit në helikopter (nëse aplikohet):*
- një certifikatë përputhshmërie të lëshuar nga personeli certifikues i autorizuar i Shitësit.

Klienti, helikopteri civil i të cilit regjistrohet në një shtet anëtar të rregullores EASA, është përgjegjës për çdo detyrë për administrimin e gatishmërisë së vazhdueshme për fluturim të helikopterit ose duhet ta transferojë këtë detyrim nëpërmjet një kontrate të nënshkruar me një organizatë të menaxhimit të gatishmërisë së vazhdueshme për fluturim (CAMO), në mënyrë që të garantohet përbushja e rregullt e aktiviteteve të menaxhimit të gatishmërisë së fluturimit, në përputhje me rregulloren në fuqi (pjesa M/nënpjesa G).

Në momentin e nënshkrimit të kontratës me Shitësin, Blerësi duhet të përcaktojë cila CAMO është e ngarkuar më këtë përgjegjësi.

Neni 16

Garancia

16.1 Shitësi garanton që furnizimet e prodhuara dhe të dorëzuara, përveç motorit(ëve) të turbinës dhe pajisjet avionike MEGHAS të jenë pa defekte në materiale dhe në prodhim, sipas një përdorimi dhe shërbimi normal.

Detyrimi i Shitësit sipas kësaj garancie është i kufizuar në riparimin ose zëvendësimin, sipas gjykimit të Shitësit, të pjesëve që pretendohet se kanë defekte, që i janë kthyer në ambientet e tij dhe që në kohën e çdo riparimi me anë të zëvendësimit, janë pranuar nga Shitësi si defektoze pas ekspertizës. Për të qenë i pranueshëm sipas kësaj kontrate, defekti i pretenduar duhet të ketë ndodhur brenda afatit të mëposhtëm, siç përcaktohet nga Shitësi:

Për helikopterin(ët) në versionin standard dhe pajisjet opsionale të instaluar:

- Brenda pesëqind (500) orëve fluturim ose tridhjetë e gjashtë (36) muajve pas pranimit të tyre përfundimtar në vendndodhjen e Blerësit, cilado periudhë që përfundon e para.

Periodha e garancisë për pjesën e riparuar ose të zëvendësuar do të zgjasë deri në përfundimin e periudhës së garancisë që kishte mbetur për pjesën defektoze. Pjesa e hequr për të cilën Shitësi furnizon një pjesë zëvendësimi, do të bëhet pronë e Shitësit.

16.1.2 Sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë nga konstatimi i ndonjë defekti, Blerësi duhet t'i paraqesë Shitësit, nëpërmjet plotësimit të formularit të ankesës së garancisë, të gjitha detajet e ankesës së tij, si edhe arsyet e tyre. Pas marrjes së formularit të ankesës së garancisë, Shitësi do t'i kthejë sa më shpejt Blerësit njoftim për marrjen dijani për ankesën e garancisë dhe formularin e autorizimit për kthimin e materialit. Brenda pesëmbëdhjetë ditëve (15) nga marrja e këtyre dy dokumenteve, Blerësi do t'i kthejë Shitësit pjesën e pretenduar me defekt.

16.1.3 Shitësi do të rimbursojë kostot e arsyeshme të transportit për pjesët e riparueshme që do të nxirren jashtë, për të cilat përfitimi prej garancisë është njohur nga Shitësi. Blerësi do t'i dërgojë Shitësit faturën në fund të vitit përkatës. Sigurimi, shpenzimet doganore dhe detyrimet e tjera, si dhe shpenzimet e Blerësit për shkak të eliminimit, riinstalimit dhe veprimeve rregulluese në lidhje me këto pjesë, do të përballohen nga Blerësi.

Për kthimin e pjesëve për të cilat përfitimi prej garancisë është dhënë nga Shitësi, kostot e transportit për kthimin e tyre brenda do të përballohen nga Shitësi.

16.1.4 Kjo garanci do të jetë e vlefshme vetëm për aq sa helikopteri dhe pjesët e instaluar në të, janë operuar dhe mirëmbajtur në përputhje me udhëzimet që përmbajnë publikimet teknike të furnizuara nga Shitësi. Përveç kësaj, kjo garanci do të jetë e vlefshme vetëm për aq sa aktivitetet e mirëmbajtjes janë regjistruar në mënyrë të rregullt në ditarin e posaçëm të udhëtimit. Ditari i udhëtimit do t'i paraqitet Shitësit nëse kjo kërkohet. Për më tepër, ky kusht do të zbatohet në lidhje me pjesët e këmbimit vetëm për aq sa këto magazinohen dhe instalohen, operohen dhe mirëmbahen siç duhet, në përputhje me udhëzimet e parashikuara nga publikimet teknike.

16.1.5 Konsumimi normal i elementeve të tilla si, por jo duke mos u kufizuar në vulat, gomat, tubat e brendshëm, llambat, paketimet dhe pjesët të ngjashme të konsumueshme, si edhe pjesët për të cilat çmimi në listën e shitjes është pesëdhjetë (50) euro, ose më pak, nuk mund t'i nënshtrohen asnjë kërkesë/ankese sipas kësaj garancie.

16.1.6 Motori(ët) i/e turbinës, si edhe pajisjet e sistemit elektronik (avionik) MEGHAS, të instaluar në helikopter, mbulohen nga garancia e dhënë nga prodhuesit e këtyre artikujve (Turbomeca dhe Thales), përfitimet e së cilës Shitësi ia kalon Blerësit. Çdo pretendim i mëtejshëm ndaj Shitësit në lidhje me këta artikuj, rrjedhimisht do të përjashtohet.

Për më tepër, Shitësi nuk do të ketë asnjë lloj përgjegjësie për pajisjet e instaluar nga Blerësi (BFE).

16.1.7 Përfshirja nga Blerësi në ndonjë helikopter të ndonjë modifikimi, i cili nuk është rekomanduar ose që nuk ka marrë miratimin e mëparshëm nga Shitësi do të shkaktojë ndërprerjen e garancisë. Për më tepër, kjo garanci nuk do të jetë e vlefshme ndaj asnjë helikopteri ose pjese që është riparuar ose modifikuar jashtë fabrikës ose qendrave të autorizuar të riparimit të Shitësit.

Garancia do të pushojë së qeni e vlefshme në rast se defekti është shkaktuar pjesërisht ose tërësisht nga ndonjë artikull defektoz që nuk është furnizuar prej Shitësit.

Garancia do të pushojë së qeni e vlefshme në lidhje me të gjitha furnizimet që janë vendosur përsëri në shërbim pas heqjes nga një helikopter i përfshirë në një aksident, përveç rastit kur Blerësi mund të provojë që defekti nuk është pasojë e aksidentit.

16.1.8 Kjo garanci i është dhënë Blerësit personalisht dhe nuk mund të transferohet prej Blerësit pa miratimin paraprak me shkrim të Shitësit.

16.1.9 Garancia e përmendur përfaqëson përgjegjësinë e vetme të Shitësit dhe zëvendëson çdo garanci dhe me përjashtim të çdo kompensimi tjetër. Shitësi nuk do të jetë përgjegjës për çfarëdo dëmi aksidental apo rrjedhues nga çfarëdo shkelje e garancisë.

Neni 17 Trajnimi

17.1 TË PËRGJITHSHME

Shitësi duhet të sigurojë pa kosto shtesë trajnime për pilotë dhe teknikë për helikopterin e dorëzuar sipas kushteve të përcaktuara në nenet e mëposhtme 17-1-2 dhe 17-1-3. Këto trajnime mund të organizohen nga Shitësi ose nga një filial i miratuar dhe i certifikuar ose nënkontraktor dhe do të kryhen në vendndodhjen e përcaktuar të dorëzimit të Shitësit jashtë Shqipërisë.

Trajnimi do të kryhet si më poshtë:

- Trajnimi për pilotët do të përfundojë në momentin e dorëzimit të helikopterit të Blerësit, të furnizuar sipas kontratës.

- Për teknikët, jo më vonë se 6 (gjashtë) muaj pas dorëzimit të helikopterit të Blerësit, të furnizuar sipas kontratës.

Nëse Blerësi nuk arrin të dërgojë personelin e tij në datën e rënë dakord me Shitësin, sipas afateve të lartpërmendura, ai do të humbë të drejtën e trajnimit.

Nëse Blerësi vendos të mos marrë pjesë plotësisht ose pjesërisht në trajnim, asnjë kredit nuk do të jepet nga Shitësi.

17.1.1 Shpenzimet e mëposhtme do të përballohen nga Blerësi:

- Mbulimi i risqeve gjatë qëndrimit në tokë dhe fluturimit, të hasura nga personeli i tij dhe rreziqet si rrjedhojë e përgjegjësisë civile të po këtij personeli;

- Shpenzime udhëtimi dhe kthimi nga vendndodhja e Blerësit në vendin e trajnimit;

- Shpenzimet e qëndrimit dhe udhëtimit në shtetin ku do të bëhet trajnimi.

Shërbimet e trajnimit të përkufizuara në nenet 17-1-2 dhe 17-1-3, sipas kësaj kontrate, do të mund t'i ofrohen vetëm pilotëve dhe teknikëve që përmbushin kërkesat paraprake në lidhje me përvojën dhe kualifikimin.

Kërkesat paraprake janë përshkruar në programin mësimor të Shitësit (në vijim i referuar si "Programi"), i cili është vënë në dispozicion të Blerësit nga Shitësi përpara nënshkrimit të kontratës. Blerësi do të jetë përgjegjës për përmbushjen e kushteve paraprake dhe kërkesave mbi kualifikimin e pilotëve. Shitësi ruan të drejtën të refuzojë çdo pilot apo teknik që nuk i plotëson këto kushte dhe/ose të ofrojë shërbimin profesional përkthimi me tarifën e tregut.

Përveç rasteve të neglizhencës flagrante të Shitësit, sjelljes qëllimisht të gabuar, Blerësi do të jetë përgjegjës për humbje dhe dëmtime të pajisjeve dhe pronës së Blerësit dhe përfaqësuesve të tij, përgjatë gjithë kohës së ndodhjes në ambientet e Shitësit.

Informacione personale që u kërkohen përfaqësuesve të Blerësit për të bërë të mundur aksesin në ambientet e Eurocopter-it do të dërgohen nga Blerësi për Shitësin të paktën (4) javë përpara datës së mbërritjes së tyre.

17.1.2 TRAJNIMI I PILOTËVE

Shitësi do të sigurojë trajnim teorik dhe praktik sipas programit bazë të vendosur nga departamenti përkatës i trajnimit për fluturim të Eurocopter-it në Gjermani. Trajnimi do të përshtatet në varësi të përvojës së mëparshme të pilotit.

Trajnimi do të kryhet për operimin e rregullave vizuale të fluturimit (VFR) për pilotë të vetëm.

Ky trajnim do t'u sigurohet pilotëve të Blerësit që janë të aftë në pilotim helikopteri dhe që zotërojnë rrjedhshëm gjuhën angleze (minimalisht niveli 4 ICAO) ose gjuhën e zgjedhur për trajnim.

Kursi do të ofrohet në anglisht:

Trajnimi i ofruar sipas rregullave të lartpërmendura përfshin sa më poshtë për helikopterin përkatës të blerë:

- EC145

- Trajnim "Pilotim i vetëm", VFR (pilot i parë) për 2 pilotë.

Kohëzgjatja: Afërsisht dhjetë (10) ditë, duke përfshirë dhe trajnime teorike dhe nëntë (9) orë fluturim.

Nëse një simulator fluturimi nuk është i disponueshëm dhe/ose nuk është në përputhje me rregulloret e autoriteteve të aviacionit civil kombëtar të Blerësit, orët e fluturimit të simulatorit do të zëvendësohen nga orët e fluturimit të helikopterëve për një kohëzgjatje të caktuar.

Trajnimi për fluturim do të kryhet në helikopterin(ët) e blerë nga Blerësi pas pranimit dhe transferimit të pronësisë së tij. Këto fluturime do të kryhen nën përgjegjësinë e një piloti të Shitësit në cilësinë e shefit të pilotëve.

Gjatë trajnimeve të fluturimeve, të zhvilluara në ambientet e Shitësit, ky i fundit do të ketë nën përgjegjësi veprimet e mirëmbajtjes të nivelit O mbi helikopter, ndryshe të gjitha veprimet e mëtejshme të mirëmbajtjes do të jenë nën përgjegjësinë e Blerësit.

Çdo pjesë këmbimi e përdorur gjatë trajnimeve për fluturim dhe që nuk përfshihet në garanci, do t'i faturohet Blerësit.

Mbulimi i arsyeshëm i sigurimit të rreziqeve që lindin nga trajnimet për fluturime, do të përfshihen në policën e sigurimit të Shitësit. Ky i fundit do të njoftojë Blerësin, me kërkesën e tij mbi

shkallën e këtij mbulimi.

17.1.3 TRAJNIMI I TEKNIKËVE

Shitësi do të organizojë në Gjermani një kurs trajnimi në tokë për teknikët e konfirmuar të Blerësit dhe në varësi të numrit dhe llojit të helikopterëve të blerë, si më poshtë:

- EC145

- Trajnim i tipit *airframe* për dy (2) teknikë mirëmbajtjeje.

Përafërsisht me kohëzgjatje prej katër (4) javësh.

- Trajnim i tipit *avionics* për një (1) teknik mirëmbajtjeje.

Përafërsisht me kohëzgjatje prej katër (4) javësh.

- Trajnim mbi motorët për dy (2) teknikë mirëmbajtjeje.

Kohëzgjatja e përafërt pesë (5) ditë.

Kurset do të zhvillohen në anglisht.

Kurset do t'u ofrohen teknikëve të Blerësit, që janë kompetentë dhe që flasin rrjedhshëm gjuhën e kursit.

Programet, datat dhe gjuhët e kurseve do të vendosen bashkërisht, jo më vonë se gjashtë (6) muaj përpara dorëzimit të helikopterit të parë të Blerësit ose në datën e nënshkrimit të kontratës, nëse koha e dorëzimit është më pak se gjashtë (6) muaj.

Trajnimet mbi motorët për teknikët e Blerësit do të ofrohen në kushte të ngjashme për rreth pesë (5) ditë ose në Donauwörth, Gjermani, ose në Shkollën Tarnos në Francë për motorët Turbomeca dhe/ose në çdo vendndodhje tjetër të aprovuar.

17.1.4 ASISTENCA TEKNIKE NË TERREN, ZHVENDOSJA E PERSONELIT TË BLERËSIT

Në mënyrë që të plotësohet trajnimi dhe të asistohet Blerësi gjatë periudhës fillestare të operimit të helikopterëve, Shitësi bie dakord të sigurojë, pa kosto shtesë dhe në një datë që do të bihet dakord, një teknik fabrike të trajnuar, për një kohëzgjatje të caktuar prej dy (2) personash/javë, për çdo helikopter;

Teknikët e Shitësit, të cilët flasin rrjedhshëm gjuhën angleze do të mbeten subjekte të ligjeve që rregullojnë marrëdhëniet e punës në vendet e tyre. Ata do të jenë në dispozicion për pesë (5) ditë pune në javë dhe për një kohë maksimale prej tetë (8) orësh në ditë.

Kjo mbështetje në terren do të ofrohet sipas zgjedhjes së Blerësit:

- ose në kohën e inspektimit të parë bazë; ose

- në çdo kohë të zgjedhur nga Blerësi, por jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) muaj nga pranimi i helikopterit të Blerësit, të dorëzuar sipas kontratës.

Nëse Blerësi nuk e shfrytëzon këtë shërbim brenda afateve të lartpërmendura, ai do të humbë mundësinë e përfitimit të tij.

Nëse Blerësi vendos të mos e shfrytëzojë plotësisht ose pjesërisht asistencën teknike, nuk do të marrë asnjë kredit nga Shitësi.

Shpenzimet e mëposhtme për teknikët mbështetës në terren do të mbulojnë nga Blerësi:

- Shpenzimet e udhëtimit drejt vendndodhjes së Blerësit dhe të kthimit në rast se Blerësi kërkon asistencë teknike për më shumë se një mision;

- Shpenzimet e transportit për arsye pune brenda vendit të Blerësit, duke përfshirë shpenzimet e udhëtimeve nga vendbanimi i tyre drejt vendit të punës dhe anasjellas.

Neni 18

Publikimet teknike

Shitësi do të ofrojë pa kosto shtesë:

- Mbështetje elektronike interaktive (DVD) bashkë me dokumentacionin e nevojshëm për mirëmbajtjen e helikopterit dhe për identifikimin e pjesëve të operimit dhe shërbimeve rutinë, për çdo helikopter të dorëzuar të Blerësit;

- Mbështetje elektronike (DVD) bashkë me dokumentacionin e nevojshëm për mirëmbajtjen e pajisjeve të instaluar në helikopterin e Blerësit dhe për të cilin furnizuesit i kanë dhënë Shitësit të drejta autori për secilin helikopter të Blerësit.

- Një kopje e printuar e:

- manualit të fluturimit për helikopterin e Blerësit.

- Të drejta aksesi mbi publikimet e informacionit teknik në internet (T.I.P.I.) për:

- buletinet e shërbimit dhe përditësimet e tyre të vazhdueshme;

- manualin e shërbimit udhëzues.

Shënim. Manuali i fluturimit duhet të jetë në përputhje me përkufizimin e helikopterit të dorëzuar të Blerësit.

Publikimi teknik do të sigurohet fillimisht në variantin e fundit në përdorim. Ndryshimet e tij për shkak të daljes së pajisjeve të reja apo instalimeve specifike për Blerësin do të sigurohen:

- Për mirëmbajtjen e publikimeve teknike: brenda katër (4) muajve pas dorëzimit të helikopterit të parë të Blerësit;

- Për publikimet teknike identifikuese brenda një kohe të përllogaritur prej tetë (8) deri nëntë (9) muaj, por jo më vonë se dymbëdhjetë (12) muaj pas dorëzimit të helikopterit të parë të Blerësit.

Publikimi teknik është në dispozicion:

- në anglisht për të gjithë helikopterët;

- në frëngjisht vetëm për helikopterët e prodhuar nga EUROCOPTER SAS, me përjashtim të radiokomunikimit amerikan dhe pajisjet e navigimit dhe manuali i mirëmbajtjes së pjesëve elektronike (EVIDOC CMM), për të cilin dokumentacioni është vetëm në anglisht.

Publikimet teknike të prodhuesve të motorëve do të dorëzohen nën përgjegjësinë e tij në vendin e Blerësit të përcaktuar në kontratë.

18.2 PËRDITËSIMET

Shitësi do të furnizojë pa asnjë kosto shtesë dhe për sa kohë që helikopteri është në operim, DVD-të e publikimeve teknike dhe manualin e fluturimit. Manuali i shërbimit udhëzues dhe buletinet e shërbimit do të përditësohen sipas T.I.P.I.

Nëse Blerësi ka paguar për marrjen e DVD-ve shtesë apo të kopjeve shtesë të printuara për të gjitha pjesët e publikimit teknik, shërbimi i rishikimit do të ofrohet pa asnjë kosto shtesë për një periudhë prej (3) vitesh pas dorëzimit të secilit helikopter të Blerësit. Pas kësaj periudhe, shërbimi i abonimit mund të rinovohet me normat vjetore mbizotëruese të publikuara nga Shitësi në kohën e rinovimit.

Në mënyrë që Shitësi të jetë i aftë të përmbushë detyrimet e tij, Blerësi merr përsipër të njoftojë Shitësin për çdo ndryshim, qoftë në adresën e Blerësit ose të emrit të pronarit, nëse helikopteri ndërkohë është shitur.

Përditësimet e publikimit teknik për motorët do të varen nga prodhuesi i motorëve:

- Për motorin(ët) Turbomeca, publikimet teknike të motorëve përditësohen nga Turbomeca pa kosto shtesë për një periudhë prej pesë (5) vitesh pas dorëzimit të secilit helikopter të Blerësit dhe abonimit për përditësimet pas kësaj periudhe.

- Për Pratt & Whitney publikimet teknike të motorëve përditësohen pa kosto shtesë nga Pratt & Whitney për një periudhë prej dy (2) vjetësh pas dorëzimit të secilit helikopter të Blerësit dhe abonimit për përditësimet pas kësaj periudhe.

Neni 19

Përgjegjësitë kontraktuale

Në rastin e një faji të provuar ose mospërputhjeje me angazhimet e marra, cilado qoftë arsyeja, përgjegjësia kontraktuale e Shitësit do të kufizohet vetëm në dëmin e drejtpërdrejtë dhe të menjëhershëm. Kjo përgjegjësi kontraktuale e Shitësit nuk do të kalojë pesëmbëdhjetë për qind (15%) të vlerës së kontratës.

Blerja e furnizimeve nga Blerësi kryhet brenda kuadrit të aktiviteteve të tij profesionale dhe Blerësi pranon me anë të kësaj shprehimisht kufizimet e përgjegjësisë, siç është përcaktuar në këtë kontratë.

Neni 20

Dëmshpërblimet

Nëse Shitësi nuk ka përmbushur detyrimet e kontratës për arsye të shkaktuara vetëm dhe drejtpërdrejt nga ai dhe, nuk arrin të dorëzojë helikopterin në datën e dorëzimit të caktuar për atë helikopter, sipas tabelës kohore të dorëzimit në përputhje me nenin 12.2, Blerësi ka të drejtën e një dëmshpërblimi (dëmshpërblimi), i cili nuk do të konsiderohet si gjobë për t'u shlyer nga Shitësi apo si borxh ndaj Blerësit, të barabartë me një shumë deri në 3% të çmimit të helikopterit të vonuar në bazë të kufizimeve të mëposhtme.

Shuma e dëmshpërblimeve do të akumulohet në nivelin 0.6% të vlerës së helikopterit të vonuar për çdo muaj vonesë, duke filluar një muaj pas datës së dorëzimit të përcaktuar fillimisht për atë helikopter, dhe duke vazhduar akumulimin për çdo muaj të ardhshëm vonesë, në mënyrë që shuma

maksimale e dëmshpërblimeve për helikopterin e vonuar të mos kalojë 3% të çmimit të helikopterit të vonuar; dhe

Kjo dispozitë përbën kompensimin dhe të drejtat e vetme të Blerësit në lidhje me shkeljen e detyrimeve të dorëzimit derisa përqindja maksimale të ketë arritur vlerën prej 3% të çmimit të kontratës si dëmshpërblime.

Neni 21 Zgjidhja

21.1 ZGJIDHJA NGA BLERËSI

Blerësi mund ta zgjidhë pjesërisht ose plotësisht këtë kontratë, në rast se Shitësi në mënyrë të vazhdueshme dështon në përmbushjen e detyrimeve të tij pa asnjë arsye dhe, pavarësisht se Blerësi ka njoftuar me shkrim Shitësin për të marrë masa të mjaftueshme korrigjuese dhe nëse masa të tilla nuk janë marrë brenda një periudhe prej gjashtë (6) muajsh pas njoftimit të mësipërm të Blerësit. Në këtë rast, do të zbatohen masat e mëposhtme:

a) Shitësi do të autorizohet të dorëzojë furnizimet e mbetura, të cilat nuk kanë qenë shkaku për mosarritjen e zbatimit të detyrimeve të tij, dhe do të paguhet për çmimin përkatës;

b) Shitësi do t'i kthejë Blerësit shumën e paradhënies dhe pagesën mbi ecurinë e punës që i korrespondon pjesës së papërmbushur të kontratës.

21.2 ZGJIDHJA NGA SHITËSI

Shitësi mund të zgjidhë pjesërisht ose plotësisht këtë kontratë, në rast se Blerësi në mënyrë të vazhdueshme dështon në përmbushjen e detyrimeve të tij pa asnjë arsye, pavarësisht se Shitësi ka njoftuar me shkrim Blerësin për të marrë masa të përshtatshme korrigjuese dhe nëse masa të tilla nuk janë marrë brenda një periudhe prej gjashtë (6) muajsh pas njoftimit të mësipërm të Shitësit. Në këtë rast, do të zbatohen masat e mëposhtme:

a) Furnizimet e përfunduara, por ende të papranuara dhe të dorëzuara/kryera në datën e marrjes nga Blerësi të një njoftimi të tillë të zgjidhjes do të pranohen në zbatim të dispozitave të kësaj kontrate dhe do të dorëzohen nga Shitësi dhe do të paguhet nga Blerësi.

b) Blerësi do të rimbursojë Shitësin për të gjitha kostot e vërtetuara rregullisht (duke përfshirë, por pa u kufizuar në lëndën e parë, punën, kostot operationale, magazinimin dhe tarifatat financiare) të shkaktuara nga Shitësi ose, të cilat Shitësi nuk mund t'i shmangte (duke përfshirë dëmshpërblimet për zgjidhjen, nëse ka, në bazë të kontratave ndërmjet Shitësit dhe nënkontraktorëve ose furnizuesve të tij, ose nënkontraktorëve, ose furnizuesve të tij të nivelit të dytë).

c) Gjithashtu, Blerësi do t'i paguajë Shitësit një dëmshpërblim për zgjidhjen, të barabartë me dhjetë për qind (10%) të vlerës totale që Blerësi i detyrohet, sipas shkronjës "b" të këtij neni.

21.3 ZGJIDHJA PËR SHKAK TË FORCËS MADHORE

Në rast të një ngjarjeje të forcës madhore sipas klauzolës 12.4.2, e cila zgjat më shumë se gjashtë muaj (6) të njëpasnjëshëm, palët do të takohen për të përcaktuar se në cilat kushte ato dëshirojnë të vazhdojnë zbatimin e kontratës ose në rast se nuk arrijnë ndonjë marrëveshje brenda një periudhe njëmuajore, secila nga palët ka të drejtën për të zgjidhur kontratën.

Brenda tre muajve nga marrja e njoftimit nga pala që synon të zgjidhë kontratën, palët do të gjejnë një marrëveshje.

Neni 22

Gradimi i instrumenteve, shenjat dhe lyerja e jashtme

Informacioni që parashikohet në nenin 22 do t'i jepet Shitësit jo më vonë se një (1) muaj pas nënshkrimit të kontratës dhe në bazë të mostrave të ofruara nga Shitësi.

22.1 GRADIMI I INSTRUMENTEVE

Instrumentet e fluturimit gradohen si më poshtë:

- | | |
|---------------------------------------|---|
| - Indikator i shpejtësisë së ajrit: | nyje ose km/orë; |
| - Matësi i lartësisë: | këmbë (fut) ose m; |
| - Kursi i ngjitjes: | këmbë (fut)/mn ose m/mn; |
| - Presioni hidraulik: | bar; |
| - Instrumentet matëse të karburantit: | kg ose litra, ose gallonë, ose gallonë imperialë. |

22.2 SHENJAT DHE LYERJA E JASHTME DHE VESHJA E BRENDSHME

Përveç kur deklarohet ndryshe në specifikimin e tipit të helikopterit korrespondues, shenjat e bëra në pjesën e brendshme dhe të jashtme të targave dhe etiketave do të jenë në gjuhën angleze.

Udhëzime të hollësishme në lidhje me:

- skemën e jashtme të bojës së korpusit të mjetit fluturues;
- ngjyrat e veshjes së brendshme dhe nëse është e nevojshme, veshjen e zgjedhur.

22.3 EMBLEMAT KOMBËTARE DHE REGJISTRIMI

Emblemat dhe regjistrimet kombëtare mund të pikturohen nga Shitësi mbi korpusin e mjetit të fluturimit përpara dorëzimit. Në këtë rast, Blerësit do t'i kërkohej të japë udhëzime të hollësishme për skemën e bojës dhe brenda të njëjtit afat kohor.

Blerësi do të jetë përgjegjës dhe do të ruajë Shitësin të padëmtuar nga ndonjë shkelje e të drejtave të palëve të treta në lidhje me dhënien e udhëzimeve në lidhje me emblemat, shenjat ose regjistrimin.

Neni 23

Hyrja në fuqi

Të gjitha afatet dhe kushtet e përcaktuara këtu janë pranuar dhe miratuar nga të dyja palët.

Palët bien dakord mbi përmbushjen e veprimeve të mëposhtme:

1. Nënshkrimi i kontratës;
2. Lëshimi i formularit të garancisë sipas nenit 11.4.1;
3. Ratifikimi i kontratës nga autoriteti kompetent shqiptar;
4. Marrja e paradhënies së parë prej Shitësit në llogarinë bankare të Shitësit, siç përcaktohet në nenin 11.2;

- Kontrata do të hyjë në fuqi në datën e marrjes prej Shitësit të paradhënies së parë në llogarinë bankare të Shitësit, siç përcaktohet në nenin 11.2 (data e hyrjes në fuqi të kontratës).

Pas përmbushjes së të gjitha veprimeve të mësipërme, Shitësi do t'ia komunikojë këtë me shkrim Blerësit.

Në rast se më 30 prill 2011, kontrata nuk ka hyrë ende në fuqi, Eurocopter do të ketë të drejtë, sipas zgjedhjes së saj, ose ta konsiderojë kontratën si të pavlefshme ligjërisht dhe t'ia deklarojë këtë me shkrim palës tjetër, ose të hyjë në bisedime, në mënyrë që të ndryshojë afatet dhe kushtet e kësaj kontrate.

Kjo kontratë me preambulën e saj, njëzet e tre (23) nene dhe anekset e saj: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10 dhe 11, është bërë në gjuhën angleze në një kopje origjinale për secilën palë.

Nënshkruar për Blerësin

Nënshkruar për Shitësin

LIGJ
Nr.10 447, datë 14.7.2011

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7703, DATË 11.5.1993 “PËR
SIGURIMET SHOQËRORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 35 bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Paragrafi i katërt shfuqizohet.
2. Paragrafi i pestë ndryshohet si më poshtë:

“Rregullat për organizimin dhe funksionimin e KMCAP-ve Eprore caktohen me këtë ligj. Rregullat për organizimin dhe funksionimin e KMCAP-ve të nivelit të parë caktohen me rregullore të ISSH-së dhe Ministrisë së Shëndetësisë.”.

Neni 2

Pas nenit 39 shtohen nenet 39/1, 39/2, 39/3 dhe 39/4 me këtë përmbajtje:

“Neni 39/1

Ankimi në Komisionin Epror

1. Kundër vendimit të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë të nivelit të parë, personi mund të bëjë ankim brenda 30 ditëve në Komisionin Epror Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (më poshtë Komisioni Epror).
2. Ankimi paraqitet në formën e parashikuar me vendim të Këshillit të Ministrave.
3. Vendimi i Komisionit Epror është i formës së prerë.

Neni 39/2

Përbërja e Komisioneve Eprore

1. Komisionet Eprore përbëhen nga 5 anëtarë secili, të cilët zgjidhen në detyrë me vendim të Këshillit të Ministrave.
2. Kryetari dhe 3 anëtarët e Komisionit Epror zgjidhen me propozim të përbashkët të Ministrit të Financave, ministrit që mbulon fushën shëndetësore dhe ministrit që mbulon çështjet sociale. Ministrat propozojnë dy kandidatura për çdo vend të anëtarit të Komisionit Epror. Anëtari i pestë i Komisionit Epror propozohet nga Ministri i Drejtësisë, me kandidaturë alternative, me profesion jurist dhe me përvojë në fushën gjyqësore.
3. Anëtar i Komisionit Epror mund të emërohet shtetasi që përmbush këto kritere:
 - a) të jetë me gradë shkencore “Profesor”, “Profesor i asociuar” ose “Doktor shkencash”;
 - b) të ketë përvojë profesionale prej jo më pak se 10 vjet punë në fushën e vet të ekspertizës;
 - c) të mos jetë i dënuar penalisht;
 - ç) të ketë një figurë të pastër morale.

4. Rregullat e detajuara për organizimin dhe funksionimin e Komisioneve Eprorë, si dhe masa e shpërblimit mujor të tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 39/3

Mandati i anëtarit të Komisionit Epror

1. Anëtari i Komisionit Epror ka mandat 4-vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje.
2. Anëtari i Komisionit Epror e ushtron këtë detyrë me kohë jo të plotë.
3. Anëtari i Komisionit Epror e ushtron funksionin në mënyrë të pavarur dhe në përputhje me bindjen e tij profesionale.
4. Përpara fillimit të detyrës, anëtari i Komisionit Epror kryen betimin në një ceremoni publike, të organizuar nga Ministri i Financave, ministri që mbulon fushën e shëndetësisë dhe ministri që mbulon fushën e çështjeve sociale.
5. Teksti i betimit përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 39/4

Mbarimi para kohe i mandatit

1. Mandati i anëtarit të Komisionit Epror mbaron para kohe kur:
 - a) dënohet nga gjykata me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
 - b) nuk paraqitet, pa arsye, në detyrë për më shumë se dy mbledhje radhazi;
 - c) jep dorëheqjen;
 - ç) deklarohet i paaftë me vendim gjykate të formës së prerë.
2. Anëtari i Komisionit Epror shkarkohet nga Këshilli i Ministrave:
 - a) për shkelje të dispozitave të këtij ligji apo akteve të tjera ligjore;
 - b) kur kryen veprimtari, që krijon konflikt interesash.
3. Në rast se vendi i anëtarit të Komisionit Epror mbetet vakant, ai zëvendësohet sipas procedurës së përcaktuar në nenin 39/2 të këtij ligji, pas 15 ditëve nga çasti i krijimit të vakancës dhe qëndron në detyrë deri në përfundimin e afatit të anëtarit që ka zëvendësuar.”.

Neni 3

Nxjerrja e akteve nënligjore

Këshilli i Ministrave, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit, nxjerr aktet nënligjore në zbatim të neneve 39/1, 39/2 dhe 39/3 të këtij ligji.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.7062, datë 27.7.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-eksponitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2011, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE	328 lekë
PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 2.8.2011
Doli nga shtypi më 3.8.2011

Tirazhi: 1700 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2011

Çmimi 40 lekë